[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi RILINDASI

VITI II - NR. 88 E diel, 15-04-2012

SHQIPTARJA.com uron besimtarët Gëzuar Pashkët

SUPLEMENTI "RILINDASI" ▶ Faqe 13-20



Dhori Qiriazi: Ju rrëfej takimin e poetëve me Enver Hoxhën në 1961

Çfarë folën Fatmir Gjata dhe Andrea Varfi dhe si u përgjigjën Arapi dhe Kadare

INTERVISTA

"Ilir Meta nuk ka se ku të shkojë"

Parashikimi i Tritan Shehut: Te PD do vijnë edhe Dule, Milo dhe Ndoka

TIRANE

JAKIN MARENA

Ish-Kryetari demokrat, deputeti Tritan Shehu ka mohuar mundësinë e largimit të LSI nga koalicioni me PD, referuar zhvillimeve të fundit në Kuvend. Ai jo vetëm që e mohon prishjen e LSI me PD, por thotë... ▶ Faqe 2-3



REPORTAZHI ▶ Faqe 10-11

Dukagjini, pa rrugë, mësues dhe investime

Udhëtim në Veriun e harruar nga qeveria, pse s'ka votues



INTERVISTA/ Denoncimi i bashkëshortit të ish-ministres. Vdiq në 21 mars, pas aksidentit në dhjetor

"PO VARROSET DOSJA E VDEKJES SE ESMERALDES"

Dashamir Uruçi: Ekzekutori shëtit i lirë rrugëve të Shqipërisë, pi kafe dhe "bën hajgare". U la i lirë brenda 24 orëve, si të kishte plagosur rëndë dy pata. Bashkëshortja ime kalbet nën dhè

VOTIMI ▶ Faqe 4



Bamir Topi: Nënkryetarin e KLD-së e zgjedh vetëm unë"

Lajmi

Dashamir Uruçi, bashkëshorti i ish-ministres së Kulturës, Esmeralda Uruçi, që ndërroi jetë tre javë më parë, denoncoi dje për "Shqiptarja.com" se drejtësia la të lirë shtetasin që i aksidentoi në dhjetor, duke sjellë edhe vdekjen e gruas. Ai i bëri thirrje prokurorisë për hetimin sa më të shpejtë të kësaj çështje dhe arrestimin e autorit të aksidentit.

TIRANE

ELTON QYNO

Rreth tre javë nga vdekja tragjike e ish-ministres së Kulturës Esmeralda Uruçit, autori që shkaktoi aksidentin automobilistik Artan Kotarja vazhdon të qëndrojë i lirë... ▶ vijon në faqe 6-7



Në foto: Dashamir dhe Esmeralda Uruçi *(fotomontazh)*

Koment



NGA EDI RAMA

Votat e Vishës u vodhën si në Ruzhdije

Duke mbështetur kandidaturën e Ardian Vishës, avokatit të Fatmir Mediut, ne nuk ndërruam asnjë presje në qëndrimin tonë ndaj krimit shtetëror të Gërdecit. Kjo këtu nuk është një përpjekje për të justifikuar gjësend lidhur me mbështetjen që dhamë për Vishën. Eshtë vetëm shpjegimi krejt i sinqertë i një pikëpamjeje që nuk e ndaj me asnjë ndër ata opozitarë të ndershëm, të cilët e lexuan dhe e komentuan nga një këndvështrim tjetër zgjedhjen tonë. Prej atij këndvështrimi Partia Socialiste u keqgjykua në zgjedhjen e saj, me jo pak komente denigruese. E sot dua të shpjegohem në respekt të gjithë atyre qytetarëve opozitarë që na keqgjykuan dhe vetëm të tyre, sepse maskarenjve politikë, të cilët kanë fajin e llogores së pushtetit për krimin e pandëshkuar të Gërdecit apo ndjekësve të tyre që u mbajnë anën qorrazi, nuk u detyrohem asnjë shpjegim. Asnjëherë.

Prifti dhe Avokati ishin dy profesione të ndaluara me ligj nga diktatura, si pasojë e asgjësimit nga njëra anë të së drejtës për të besuar apo për t'u rrëfyer dhe nga ana tjetër, të së drejtës të çdo të akuzuari, edhe për krimet më monstruoze, për t'u prezumuar i pafajshëm përpara gjyqit të "popullit". Por a është në fakt prifti bashkëfajtor për çka mban kyçur brenda... ▶ vijon në faqe 5

RAPORTI ▶ Faqe 8

BE dhe KiE: "Politika shqiptare pastron paratë"

GRABITJA ▶ Faqe 7

Plagosin pronarin, marrin 500 gr flori dhe arrestohen

MUSLIMANET ▶ Faqe 9

Xhamia te Namazgjaja, do falemi sërish në rrugë

DYQANI VIP ▶ Faqe 21

BUTIKU I MILIONEREVE, JA GRATE QE DHUROJNE

Rrobat mijëra euro firmato shiten për 5 mijë lekë



NERANXI 1991

... gjithmonë një hap përpara...

Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.

Lajcak-Haxhinasto: Statusi kandidat varet nga Shqipëria

Zv.Kryeministri e Ministri i Punëve të Jashtme Edmond Haxhinasto mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar për Sigurinë Globale "Globsec 2012", i cili i zhvilloi punimet në Bratislavë të Sllovakisë.
Ai u prit në një takim të veçantë nga Zv.Kryeministri e Ministri i Jashtëm i porsaemëruar i Sllovakisë, Miroslav Lajçak.
Ai u shreh se 'vërtet në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime pozitive, për të çuar në një lajm pozitiv drejt marrjes së statusit të vendit kandidat, por çdo gjë varet nga Shqipëria'. Në takim u diskutua mbi zhvillimet në Shqipëri me theks të veçantë procesi i integrimit në BE, zhvillimet rajonale, si dhe aspekte të bashkëpunimit dypalësh.
Nga ana e tij, Haxhinasto theksoi progresin e bërë në Shqipëri në drejtim të reformave, si dhe të situatës politike, duke nënvizuar se këto zhvillime pozitive duhet të kenë vlerësimin e Brukselit dhe vendeve anëtare të BE-së, për dhënien e statusit të vendit kandidat. Kjo jo vetëm që do të jetë e merituar për shqiptarët, por do të fuqizojë më tej edhe rolin dhe inkurajimin për reforma të reja në Shqipëri. Në takim u diskutua edhe për zhvillimet në rajon dhe Kosovë.

Ish-kryetari demokrat garanton zgjerimin e koalicionit me Ndokën, Milon e Dulen

Shehu: LSI s'ikën nga PD Meta s'ka besim te Rama

Deputeti i PD: Nano president nuk sjell rrëzimin e qeverisë



Në foto: Protesta e deputetëve të PS-së pas shpalljes së Elvis Çefës si anëtari i KLD-së

Lajmi

Ish-Kryetari demokrat, deputeti Tritan Shehu ka mohuar mundësinë e largimit të LSI nga koalicioni me PD, referuar zhvillimeve të fundit në Kuvend. Ai jo vetëm që e mohon prishjen e LSI me PD, por thotë se në koalicion do vijnë dhe Ndoka, Milo e Dule. Për të, Nano President s'bashkon Metën me Ramën as rrëzon qeverinë



Në foto: Deputeti Tritan Shehu

Presidenti

"Nuk ka asnjë pasojë kandidimi i Nanos për President në fatet e qeverisjes deri në fund të këtij mandati. Dhe nëse nuk bëhen votat, do të zgjidhet një president ose i njëriës palë ose i palës tjetër pa asnjë ndikim anë fatet e qeverisjes".

TIRANE

JAKIN MARENA

Ish-kryetari i PD, deputeti Tritan Shehu është shprehur i bindur se LSI nuk ikën, pasi Meta nuk i beson Ramës. Ai shprehet se koalicioni i djathtë është gati të presë përpos Ndokës e Milos dhe Dulen, duke paralajmëruar se s'do ketë rrezik që qeverisja e djathtë të rrëzohet para vitit 2013.

Rezultati i votimit për anëtarin e KLD tregoi se PD e ka shumë të vështirë mbijetesën pa LSI. I trembeni largimi të Metës?

Unë s'mendoj se LSI e drejtuar mund të largohet nga koalicioni i tanishëm qeverisës për shumë arësye. Unë mendoj se në koalicionin me PD Meta ka gjetur partneritetin e duhur, një aleancë serioze dhe të respektueshme. S'besoj se lëviz nga koalicioni.

Por në votimin në Kuvend të enjten, që është parë dhe si "provë gjenerale" për zgjedhjen e Presidentit, tre deputetët e LS, me në krye Metën u larguan ama, ishte moment i vështirë...?

Nuk e mendoj një gjë të tillë. Në lidhje me largimin nga votimi, kryetari i LSI, Meta i ka dhënë shpjegimet e duhura. Ata ikën sepse pati vonesa në procesin e votimit për faj të PS që s'ra dakord për mënyrën e votimit, më saktë për kohën e vulosesjes dhe firmosjes së fletëve të votimit, çka solli votimin elektronik e bojkotin e PS. Meta e dy deputetët e tjerë të LSI kishin një takim të planifikuar. Vonesa në votim bëri që ata të largoheshin.

Po flitet se ka negociata sekrete të Metës me Ramën...?

LSI nga koalicioni me mazhorancën e djathtë dhe konkretisht me PD s'ka pasur humbje, por them se ka përfituar e ajo nga koalicioni me PD, pa përjashtuar se dhe PD ka përfituar nga koalicioni me LSI, në funksion të mirëqeverisjes, bërjes së reformave dhe integrimit të Shqipërisë në BE. Eshtë hequr sistemi i vizave, ka rritje ekonomike, pasi vendi s'është prekur nga krimi, pra ka zhvillim.

"Unë s'mendoj se LSI e drejtuar mund të largohet nga koalicioni i tanishëm qeverisës për shumë arësye. Në koalicionin me PD Meta ka gjetur partneritetin e duhur".

Pastaj s'besoj se Meta shkon në koalicion me Ramën, sepse kreu i LSI nuk i beson Edi Ramës. Kreu i PS s'krijon siguri e garanci për aleatët, pastaj janë duke i ikur aleatë dhe PD po përgatitet ta zgjerojë koalicionin me parti të tjera, madje dhe të spektrit opozitar.

Pra PD kërkon zgjerim drejt opozitës, duke shfrytëzuar dhe sherrin që ka shpërthyer tek partitë e majta....?

Unë e kam deklaruar dhe më parë, se koalicioni i djathtë i drejtuar nga Berisha është i hapur dhe për parti të tilla opozitare, si PDK e Ndokës, që është parti e djathtë dhe ka qënë në koalicionin qeverisës me PD dhe për PDS të Paskal Milos që është një parti e majtë. S'mund të them se mund të ketë koalicion me PSD e Gjinushit që është deklaruar se dhe nëse ikën nga PS bashkohet në koaolicion jashtë PS vetëm me parti të majta.

Domethënë PD, për të garantuar qeverisjen është gati të mbështetet tek aleatët e rinj...?

Patjetër që po. Madje Berisha është i gatshëm për të negociuar e pritur në gjirin e koalicionit të djathtë aleatët e rij, qoftë dhe nga e majta opozitare. Lideri i PD di të bëjë koalicione, di të krijojë kushtet më optimale që ata të ndjehen mirë, duke i trajtuar si partnerë dhe me rëndësinë e duhur që meritojnë.

Berisha është i hapur për të pranuar dhe PBDNJ e Vagjel Dules në koalicionin e djathtë qeverisës...?

Vangjel Dule, për vetë peshën që përfaqëson partia që ai drejton, PBDNJ, për vetë sjelljen konstruktive e në funksion të integrimit që ka mbajtur gjithnjë, është në plan të parë për t'u ofertuar për të marrë pjesë në aleancën e djathtë qeverisëse. S'ka përse të mos ftohet në koalicion, aq më tepër që Rama nuk di të sillet me aleatët, të cilët po i largohen një nga një.

Po Idrizi i PDIU ka kërcënuar se ikën nga koalicioni nëse vjen Dule...?

Nuk e besoj, pasi koalicioni mes PD dhe PDIU nuk është bërë me kushte. Unë jam i bindur se Idrizi është solid në bashkëpunimin me Berishën. Ndaj s'mendoj se do të ketë surpriza.

Një largim i LSI, nuk mendoni se sjellë rrëzimin e qeverisë...?

Jam i bindur se LSI nuk largohet dhe i qëndron marrëveshjes bashkëqeverisëse. Ritheksoj s'ka probleme në koalicion.

As kandidimin i Nanos për president nuk sjell pa-

"Dule, për vetë peshën që përfaqëson partia që ai drejton, PBDNJ, për vetë sjelljen konstruktive e në funksion të integrimit që ka mbajtur gjithnjë, është në plan të parë".

soja, pasi votat e LSI, Islamit dhe të PDIU mendohet se kalojnë për Nanon...?

Nuk ka asnjë pasojë kandidimi i Nanos për President në fatet e qeverisjes deri në fund të këtij mandati. Dhe nëse nuk bëhen votat, do të zgjidhet një president ose i njëriës palë ose i palës tjetër pa asnjë ndikim anë fatet e qeverisjes. Për këtë jam shumë i bindur që nuk do ketë krizë qeveritare pas Presidentit.

LSI ka deklaruar se koalicioni me PD është deri në zgjedhjet e 2013. Parashikoni të hyni në zgjedhje pa Metën, por me të tjerë?

PD është e hapur për të pritur dhe parti të reja në koalicionin parazgjedhor për vitin 2013. Sa për LSI, mund të them se ajo marrëveshjen e koalicionin bashkëqeverisës e ka për një mandat. Por kjo s'do thotë se nuk do arrihet një marrëveshje e re për të hyrë bashkë në zgjedhje. Berisha është shumë aftë të realizojnë koalicione efikase.

Por kandidatura e Nanos për President mund të shërbejë për bashkimin e PS me LSI. Në votimin për Cefën koalicioni cedoi...?

Ajo që ndodhi në votimin e fundit në Kuvend për anëtarin e ri të KLD ka të bëjë me diversitetin që ekziston brenda një koalicioni demokratik. Një koalicion nuk është i ngjashëm me një parti politike, por ka diversitet, qëllim, vendimmarrje dhe procedim të ndryshëm. Kjo mënyrë diversiteti brenda koalicionit mazhoritar e bën atë solid, të fortë, demokratik dhe të pëlqyeshëm dhe për ato parti që janë në koalicione të tjera, deri te e majta.

Por ka shumë gërryrje te e djathta, pasi kërcënojnë jo vetëm koalicionet, por dhe partia e Topit, e Spahiut...?

Do jetë një parti e vogël, siç është bërë traditë tashmë. Mendoj se është e impostuar gabim në pozicionin e saj politik. PD ka qënë, është e do jetë kolona e lokomotiva e së djathtës në vend.

Po gërryrja vazhdon ama...?

Në një anë duket sikur ka gërryrje, por nga ana tjetër ka ardhje.

MARK MARKU:



"Mungesa e LSI në votim, për PD kërcënim"

PD e sheh mungesën e tre përfaqësuesve të LSI në votimin për anëtarin e ri të KLD, tërësisht të karakterit politik, deri dhe si një veprim kërcënues ndaj së djathtës. Për "Ora News" deputeti i PD Mark Marku, e cilësoi një veprim jokorrekt dhe joluajal, në kushtet e mungesës së një pike reference. Por sipas tij PD e provoi veten dhe vërtetoi se është në gjendje të bëjë manovrime brenda koalicionit. "Për LSI ishte një lojë politike, e natyrshme për koalicionet. LSI ka dashur të tregojë njëfarë force, por ka vepruar në mënyrë joluajale, ishte një veprim kërcënues për sa kohë s'ka pasur mospërputhje. Unë mendoj që ky është një sinjal. PD e ka testuar forcën dhe brenda koalicionit ne kemi mundësi për të manovruar, në këtë fazë PD luan në mënyrë më komode. Çdo force politike i lind e drejta për të bërë manovrime", tha ai.

Ligjet, deputetët t'i votojnë pas ndërhyrjes së ekspertëve të huaj

Përafrimi i legjislacionit të Shqipërisë me atë të BE, kalon projektligjet e qeverisë në filtrin e ekspertizës europiane. Projektligjet përpara se të shkojnë në mbledhjen e qeverisë konsultohen me ekspertët e huaj në Tiranë, ose me ekspertët në Bruksel për përshtatjen e draftligjeve të cilat kthehen në ligje pasi kalojnë në filtrin e fundit në Parlament. Drejtori për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në Ministrinë e Integrimit, Naim Hushi thotë se përafrimi bëhet për çdo nismë ligjore që vjen nga qeveria. Sipas tij, konsultimi për një projektligj kërkon kohë nga 3 javë deri në një muaj. "Nëse ka asistencë aktuale në vend sigurisht që këto draftligje konsultohen me to. Në rastet e fushave specifike që ndoshta mund të mos ketë asistencë të drejtëpërdrejtë sigurisht merr masa, sipas nevojës, që tëkonsultohet dhe me ekspertët e BE nëpërmjet instrumentave të caktuara, nëpërmjet ministrisë së Integrimit, me kërkesa specifike dhe kjo gjë ndodh", thotë Naim Hushi. Projektligjet më të fundit që kanë kaluar nën filtrin e ekspertëve të vendeve anëtare të BE janë ato që kanë munduar politikën deri në gjetjen e një konsensusi.



Nënkryetari i grupit të PS

Braçe: Luksi në pushtet i një vendi në një krizë të thellë ekonomike, po vret

TIRANE

Nënkryetari i grupit parlamentar të PS Erjon Braçe ka reaguar ashpër ndaj asaj që ai e cilëson luks të qeveritarëve me paratë e shtetit shqiptar. "Kronika e gazetave të sotme(djeshme): Lajmi i parë: Berisha luftë Presidentit edhe me guzhinierin. Bëhet fjalë për një vendim të Qeverisë që rrit rrogat e guzhinierëve të Berishës ndërkohë që Presidentin e kanë lënë vetëm me një guzhinier dhe një kamerier. Paskan dhe guzhinierë më vete këta? Po gratë dhe vajzat e tyre gatuajnë ndonjëherë", thotë numri dy i grupit të PS, Braçe në profilin e tij në rrjetin social facebook. Por nuk mjaftohet vetëm me këtë lajm deputeti socialist, teksa nuk ka munguar të komentojë dhe festimet



Erjon Braçe

në familjen Meta. "Lajmi i dytë: Monika dhe Iliri harbohen për ditëlindjen e Monikës. Bëhet fjalë për një festë të organizuar në një prej hoteleve më të shtrenjtë të Tiranës për nder të ditëlindjes së Monikës që paska mbushur vetëm 38 vjeç. Mirë para, po modesti a kanë këta", thotë Braçe. Ndërsa për të lajmi i tretë ka qënë vërtetë befasues për Braçen, teksa thotë se "Festë surprizë drejtoreshës së Jozefina Topallit. Bëhet fjalë për ditëlindjen e Lefit ose Lefteri Lleshit, drejtores juridike të Jozefina Topallit si dhe anëtare e KLD", shkruan Braçe. Ai u ka bërë koment të tre lajmeve, duke këmbëngulur se janë paratë të harxhuara pa hesap nga paratë e taksapagueve shqiptarë. "Nga lart e deri pak më poshtë për përsëri lart në pushtet, para shpenzohen pa hesap për temenara e festa. Paratë publike po e po, por dhe paratë private të funksionarëve publikë po sfidojnë një popull të tërë të zhytur në varfëri", thotë Braçe.

Kryetari i LSI qetëson Berishën: Mazhoranca është funksionale, kush ka dyshime për këtë le ta verifikojë

Meta: Çarja PD-LSI, hamendësim

Aleati i PD në koalicionin qeverisës i bën thirrje politikës shqiptare: Nga palët duhet evituar fryma konfliktuale dhe të detoksiokohet klima politike në funksion të integrimit në BE. Zgjedhja në KLD të mos politizohet

TIRANE

JAKIN MARENA

Partia e dytë më e madhe pas PD në qeverisje, përmes kryetarit të saj e ka garantuar dhe njëherë liderin e mazhorancës Berisha se nuk do të ketë asnjë lëkundje në marrëdhënjet bashkëqeverisëse me të. Kështu, kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, i konsideron si hamendësime krisjen që pësoi koalicioni qeveritar gjatë votimit të anëtarit të KLD-së në Kuvend para disa ditësh. "Mazhoranca është funksionale dhe kush ka dyshime për këtë le ta verifikojë", tha Meta gjatë një takimi me strukturat e Lëvizjes së Gruas për Integrim në Fier. Në këtë mënyrë, duket se Meta ka rrëzuar hamendësimet në lidhje me një çarje të koalicionit PD-LSI, duke tentuar të ulë të gjitha tonet në lidhje me mosvotimin që ai i bëri kandidaturës së Elis Cefës për anëtar të KLD në vend të Kreshnik Spahiut. "Mazhoranca qeverisë është e qëndrueshme dhe komentet për të kundërtën janë pavend", ka përforcuar deklaratën e parë kreu i LSI, Ilir Meta. I cili nuk ka munguar që të bëjë thirrje në drejtim të klasës politike shqiptare që të heqë dorë nga përplasjet politike, pasi sipas tij Shqipëria ka nevojë për reforma në rrugën e saj drejt integrimit dhe jo për sherre të palëve politike të cilat e ngadalësojnë këtë proces shumë të rëndësishëm për vendin. "Është koha që ti ikim sa më shpejt këtij konfliktualiteti që vjen nga vullneti i disa politikanëve për të ndezur konflikte. Është koha të përqëndrojmë energjitë tona në proceset primare, në integrimin në Bashkimin Europian. Nga palët duhet evituar fryma konfliktuale dhe të detoksiokohet klima politike në përgjithësi në vendin tonë pasi vetëm në këtë mënyrë reformat integruese dhe plotësimi i 12 rekomandimeve të Komisionit Europian do të mund të përshpejtohen duke afruar kështu anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian", thekson kreu i LSI-së. Më tej Meta ka bërë thirrje që në rastet e zgjedhjeve në gjyqësor procesi të mos politizohet, pasi kjo nuk i shërben një drejtësie funksionale. "Mesazhi ynë ka qenë dhe mbetet unison, zgjedhje të tilla nuk duhet të politizohen për sa kohë i përket pavarësisë së gjyqësorit, për të pasur një funksionim të mirë të drejtësisë. Për këtë arsye LSI nuk i kthen në sfida politike situata të tilla", tha Meta. Gjithashtu, kreu i LSI-së nuk ka lënë jashtë vëmendjes as situatën e krijuar në Parlament në momentin e zgjedhjes së anëtarit të KLD, teksa fajësoi opozitën për tensionimin e situatës. "Ajo ishte një shkëndijë pa zjarr, rregullat e Parlamentit duhen respektuar në mënyrë strikte, praktika e bllokimit dhe konflikteve duhet të marrë fund. Debatet janë të domosdoshme, por duhet të tregojmë vetëpërmbajtje, pasi askush nuk përfiton nga këto konflikte", tha Meta. Disa ditë më parë, Kreu i LSI u shpreh në favor të një takimi, qoftë edhe pa praninë e kamerave, mes Kryeministrit Sali Berisha dhe kreut të opozitës Edi Rama, që sipas Metës do t'i shërbejë çtensionimit të klimës politike në vend dhe do të garantojë qëndrueshmërinë në realizimin e reformave integruese.



Ilir Meta

LUAN RAMA

Vrasja në Maqedoni, LSI: Akt kriminal, të ruhet qetësia

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, përmes sekretarit të përgjithshëm të saj, Luan Rama, ka dënuar ashpër ngjarjen e ndodhur ne fshatin Smilkovc të Shkupit, ku në rrethana ende të paqarta mbetën të vrarë pesë persona. Në një konferencë për shtyp Rama dënoi tentativat dhe grupet kriminale që synojnë të nxisin dhunë ndëretnike në vend. "Dënojmë aktin dhe humbjen e jetës së pafajshme të qytetarëve, si një akt kriminal që synon të krijojë destabilitet politik. Është për të ardhur keq që ka grupe të caktuara që synojnë të provokojnë situata të tilla ndëretnike. Ajo që ka rëndësi është stabiliteti dhe fryma bashkëpunuese, në mënyrë që Maqedonia të përbushë synimet e saj për anëtarësimin në BE", tha ai. Duke u shprehur ngushëllimet familjarëve të viktimave, Rama ka inkurajuar autoritetet shtetërore që të hetojnë plotësisht këtë ngjarje, për të gjetur autorët e saj dhe për t'i vënë ata përpara drejtësisë, që të mos ketë përplasje etnike.

PS nis anëtarësimet në Tiranë, Tahiri: Gati fitorja më 2013

PS nisi dje zyrtarisht fushatën e anëtarësimeve në Tiranë. Sajmir Tahiri, kryetar i PS për degën Tiranë, theksoi se të gjitha strukturat e kësaj partie janë mobilizuar për të dyfishuar anëtarësimet në kryeqytet, në funksion të fitores në zgjedhjet e ardhshme të 2013. "PS hap dyert për t'i dhënë rrugë një procesi të pandalshëm për t'u bashkuar me të gjithë ata që sot më shumë se kurrë, kanë një arsye për t'u bashkuar me ne dhe me këdo që beson te vlerat", tha Tahiri. Në këtë kuadër, tha ai do të ngrihen 11 pika anëtarësimesh në 11 njësitë e Tiranës, si dhe 2 pika të lëvizshme po për këtë qëllim. "Strukturat e PS të Tiranës në çdo njësi, anëtarët e thjeshtë në çdo organizatë socialiste, janë përgatitur për të filluar menjëherë nga puna me një qëllim të përbashkët, dyfishimin e anëtarësisë së PS në Tiranë", tha Tahiri. Ai theksoi se fushata e anëtarësimeve në Tiranë është rruga për t'u bërë bashkë me ata që nuk pranojnë rrënimin që ofron qeveria e Sali Berishës. "Programi ynë është rruga jonë dhe e çdo qytetari të ndershëm të këtij vendi. Ndaj dhe fushata e anëtarësimeve në Tiranë është vetëm fillimi i kësaj rruge për të punuar e fituar zgjedhjet e ardhshme, në Tiranë e në të gjithë Shqipërinë, në emër të Rilindjes Shqiptare", u shpreh Tahiri

Kreu i PS: Atë që i bëri Qeveria, s'ia bënë as pushtuesit

Krujë, Rama: Berisha eksperiment makabër

Anëtarëson 260 të rinj në PS, Rama: Kontribuoni

Lajmi

Kryetari i PS gjatë takimit me të rinjtë krutanë, teksa ka anëtarësuar në PS 260 prej tyre nuk ka munguar të sulmojë kreun e qeverisë, Berisha për masakrën që ka bërë në Krujë, duke kryer mbi të sipas tij një eksperiment makabër në favor të pasurimit të një grushti njerëzish.



Thirrja

Për Ramën nëse njerëzit bëhen bashkë, jo vetëm Kruja por edhe e gjithë Shqipëria që njësoj e vuajnë varfërinë, papunësinë, korrupsionin, çmimet e larta, frika që ka hyrë çdokund si kërcënim se "po na dole kundër ne pastaj të lëmë pa bukë, ajo frikë do zmbrapset dhe përpara do hapet rruga e Shqipërisë që dëshirojmë".

TIRANE

JAKIN MARENA

Kreu socialist është ndalur dje në qytetin e Fushë Krujës, ku përmes një takimi me të rinjtë e shumtë që kishin ardhur në takim, nuk ka munguar të sulmojë kreun e qeverisë Berisha për shkatërrimin e kësaj zone. Re-FREESH është ndalur dje në Fushë-Krujë dhe bashkë me të dhe kreu socialist Edi Rama i cili është takuar me të rinjtë. Për 260 anëtarët më të rinj të PS, ky ishte një takim ku ata jo vetëm morën kartat nga kryetari i PS, por shërbeu edhe si një mundësi që të rinjtë të dëgjonin nga afër se çfarë PS dhe Programi "Për një Rilindje Shqiptare" do të bëjë veçanërisht për qytetet ku ata jetojnë. Rama gjeti rastin që të flasë jo vetëm mbi politikën dhe vlerat e saj kur njerëzit bëhen bashkë, duke ju referuar fitores së kryetarit të bashkisë së Fushë Krujës, Gjon Bardhi, por akuzoi direkt qeverinë Berisha kur tha se Kruja nuk do ishte ky qytet që është sot, nëse nuk do ta kishte në dorë një qeveri barbare si kjo që qeveris sot vendin. Rama e quajti "eksperiment makabër" atë që po i bëhet jo vetëm Krujës, por gjithë Shqipërisë, pas së cilit përfitojnë një grusht njerëzish, në mënyrë të pallogaritshme, duke lënë mbrapa shenja dhe vraga të paripareushme e të tmerrshme në trupin e një qyteti si Kruja, aq sa dhe vetë pushtuesit Krujës nuk e kanë bërë. "Doja t'ju thoja që a e parafytyroni se si do ishte një vend si Kruja me historinë që ka Kruja e me rolin që ka luajtur Kruja jo vetëm në historinë kombëtare, por dhe në historinë e Europës, nëqoftëse s'do të kishte rënë në duar barbarësh si ato që po e shkatërrojnë përditë. Nuk do të lejonin të dëmtohej asnjë gur që lidhet me atë histori. Nuk do të lejonin të pritej asnjë pemë që është rritur nën qiellin e asaj historie", deklaroi Rama. Sipas tij, s'do të lejonin të ndërtohej asnjë shëmbëlltyrë të barbarisë urbane që në fakt e cënon rëndë atë histori, nuk do ta kthenin trupin e një vendi si Kruja në një trup që duket sikur është shtirë në sallën e autopsisë pas vdekjes, duke e përdorur për një eksperiment të pamundur. Rama u foli të rinjve për papunësinë dhe se sa të lehtë do ta kishin krutanët nëse do jetonin në një qytet si shumë qytete të tjera të ngjashme në botë me historinë vlerat dhe me trashëgiminë e veçantë që ka qyteti Krujës. Por Rama tha se Krujën vazhdojnë ta rrjepin, të rrjepin çdo pasuri që është pasuria e përbashkët. "Nëse guxojnë t'ju thonë që me këto gropat e mëdha që ne po hapim mu në trupin e Krujës, me këtë pluhurin e madh që ne po ngremë mbi Krujë dhe me këtë ndotje të tmerrshme që po krijojmë, duke ua lënë juve ta mblidhni në mushkëritë tuaja dhe me ato gropat e tjera të gëlqeres që zihen nga të katër anët, ne kemi hapur vende pune dhe njerëzit po arrijnë të fitojnë diçka jo vetëm që ju gënjejnë, por ju poshtërojnë", nënvizoi kreu socialist. Rama tha se me të ardhurat që merren nga gjithë kjo masakër që bëhet mbi Krujën, jo vetëm nuk i merrin krutanët, jo vetëm nuk i merr ekonomia kombëtare, por i merr një grusht barbarësh që duke përfituar nga mungesa e madhe e pjesëmarrjes tuaj, të të gjithëve ju në politikë dhe nga varfëria, papunësia, frika që kanë kallur në zemrat e shumë e shumë njerëzve vazhdojnë ta rrjepin Krujën. "Vazhdojnë të rrjepin çdo pasuri që nuk është pasuria e dikujt, por është pasuria e të gjithëve bashkë, që nuk është pasuria e të gjithëve ne sot, por është pasuria e të parëve tanë të cilëve ne jua kemi borxh pasardhësve tanë. Dhe nga e cila duhet të përfitojnë të gjithë brezat duke e bërë Shqipërinë më të bukur, jo të përfitoj një grusht njerëzish duke e shëmtuar njëherë e mirë Shqipërinë, për ta lënë pastaj në mes të rrugës të mbushur me të çara e me të vrara që të mos i afrohet më askush", tha Rama.

LAJME SHKURT

■ Janullatos: Të dalim nga korrupsioni
Anastas Janullatos, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë uroi dje besimtarët ortodoksë për Festën e Pashkës. Ai theksoi se e kremtja e Pashkës nuk është një kremtim i thjeshtë, por një dalje nga plogështia dhe e keqja që mund të ketë përdorur njerin në forma të ndryshme. "Duke kremtuar Pashkën, ftohemi në një lëvizje vetjake për të dalë nga mëkati shumëformësh dhe shpesh i vështirë për t'u dalluar. Sipas terminologjisë së sotme kjo do të thotë dalje nga korrupsioni, gënjeshtra, paligjësia, mashtrimi, të cilat ndotin në forma të ndryshme çdo shtresë shoqërore duke minuar kohezionin e popullit. Do të thotë zgjedhje e vendosur e së vërtetës dhe e ndershmërisë. Dalje nga indiferenca për hir të drejtësisë", tha Janullatos.

■ Pashkët, fluks emigrantësh në kufi
Vijon fluksi i emigrantëve që kthehen për të festuar në vendlindje Pashkët Ortodokse. Orët e fundit autoritetet në pikat kufitare të vendit janë përballur me rritje të numrit të hyrjeve. Në Kapshticë në 24 orë kanë hyrë mbi 5500 persona dhe 1427 mjete, por mësohet se ka patur dhe dalje të shumta, ku rezultojnë rreth 2411 persona dhe 506 mjete. Mësohet se pala shqiptare po punon me 6 sportele, ndërsa kolegët e tyre greke me 2 të tilla. Situata me e lehtë paraqitet në pikën kufitare të Kakavijës, ku gjatë 24 orëve të fundit kanë mundur të hyjnë 7300 shtetas dhe 2100 mjete ndërsa kanë dalë 3900 shtetas dhe 720 mjete. Ndërkohë që në orët në vijim pritet të ketë një fluks më të madh të shtetasve që hyjnë në Shqipëri.

Kushtetuta

Topi: Nënkryetarin e KLD e zgjedh unë

TIRANE



Kreu i shtetit, Bamir Topi që nga qyteti i "serenatave" Korçë ka lëshuar një sinjal të fortë për politikën shqiptare dhe në veçanti për kreun e mazhorancës në pushtet, Sali Berisha. Duke i kujtuar kryeministrit por dhe të gjithë atyre që e mbështesin se në Këshillin e Lartë të Drejtësisë është ai "zot" dhe se ka në dorë propozimin e kandidaturave për nënkryetar të KLD si dhe zgjedhjen e pasuesit të Kreshnik Spahiut në këtë post, i cili dha dorëheqjen përpara se komisioni parlamentar hetimor i ngritur nga mazhoranca të merrte vendimin për ta shkarkuar. Presidenti i vendit Bamir Topi duke mos dashur të komentojë incidentin e ndodhur gjatë seancës së të ejtes, ku Kuvendi miratoi vetëm me votat e mazhorancës kandidaturën e Elvis Cefës për postin vakant në KLD, pas largimit të nënkryetarit Kreshnik Spahiu deklaroi se KLD gjatë mbledhjes së nesërme do të njoftojë emërimin e tij.

Në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Topi bëri me dije se "zgjedhja e nënkryetarit është e drejtë Kushtetuese e kreut të shtetit", ndërkohë nënvizoi se një nga anëtarët aktualë të e KLD-së mund të zërë postin. Në këtë rast, kreu i shtetit, teksa është shprehur se një ndër anëtarët aktualë do të zërë vendin e Spahiut si numri dy i KLD ia ka hequr të gjitha shpresat mazhorancës dhe Berishës për të dërguar në poltronin e numrit dy të KLD, pikërisht të sapozgjedhurin në mënyrë të diskutueshme për shkak të përplasjes mes mazhorancës dhe opozitës në Kuvend për mënyrën e votimit, Elis Cefën. Këto deklarata presidenti Topi i bëri dje nga qyteti i Korcës, gjatë vizitës së tij për festën e pashkëve Ortodokse. Mazhoranca u investuar deri në atë shkallë për zgjedhjen e Cefës në KLD, sa shkeli dhe mbi Kushtetutën e rregulloren e Kuvendit, që përcakton qartë se votimi për individë bëhet me votë të fshehtë e me kuti, ndërkohë që Topalli me "bekimin" e Berishës realizoi votimin elektronik. Ndërkohë që Cefa fitoi me vota minimale duke çarë mazhorancën.

Denoncimi i Aleancës Kuqezi: Qeveria, monopole në transporte

Aleanca KuqZi denoncoi dje skandalin me kompanitë monopol që operojnë në Shqipëri në transportin ajror dhe detar. Aleanca vuri theksin tek mungesa e kokurrencës, sepse kjo rrit në mënyrë fiktive çmimin, duke rënduar xhepat e qytetarëve shqiptarë. Duke dhënë raste konkrete dhe transportet analogë në rajon, AK-ja fajëson qeverinë shqiptare për mënyrën se si lejohet të operohet në një treg të lirë. "Për shkak të mungesës së konkurrencës së lirë shqiptarët paguajnë sot çmimet më të kripura për biletat e avionit. Mungesa e një linje ajrore kombëtare, dhe një që ishte me financim të huaj, por që u mbyll me çdo kusht, ka krijuar në sektorin e transportit ajror një kosto të lartë për udhëtarët shqiptarë. Prej muajsh dy kryeqytetet shqiptare Tirana dhe Prishtina nuk lidhen me linjë ajrore dhe askush nuk flet për këtë.", thuhet në deklaratën e Ak-së. AK denoncoi edhe faktin që në sektorin detar nuk ka një linjë detare me origjinë shqiptare, por vetëm të huaja. "Me këtë qeveri nuk do të kemi asnjëherë një kompani me baza shqiptare në sektorin e transportit detar", thuhet ne deklaratë. Ndërsa në lidhje me transportin hekurudhor, AK nënvizon se ai nuk ekziston, dhe prej 22 vitesh nuk ka njohur asnjë investim.

Kryetari i PS-së flet për votimin e anëtarit të KLD

Votat e Ardian Vishës u vodhën si në Ruzhdije

"Saliu nuk ka më shumicë të fshehtë në atë parlament"

TIRANE

EDI RAMA

vijon nga faqja 1

...vetes prej tmerreve që i bie të dëgjojë në dhomën e rrëfimit?Po avokati a është bashkëfajtor për akuzat që rëndojnë mbi klientin, cilatdoqofshin bëmat apo gjëmat e klientit? Padyshim jo, as njëri as tjetri nuk janë të fajshëm dhe askush s'ka të drejtë në një shoqëri të lirë të gjykojë keq as priftin, pse nuk denoncon në prokurori rrëfimtarët e mëkateve që lidhen me shkeljen e ligjit, as avokatin, pse merr përsipër të mbrojë njerëz të akuzuar për shkeljen e ligjit nga prokuroria. Sepse nëse prifti nuk mund të bëjë detyrën e tij apo avokati të tijën, vetë shoqëria ka humbur lirinë dhe drejtësinë. Kriminelët nazistë të gjyqit të Nurembergut u mbrojtën të tërë me avokatë përballë gjykatësve të botës së lirë. Kurrëkujt s'i vajti mendja të pështynte avokatët po përkundrazi, avokatia e atyre monstrave të racës njerëzore në sallën e gjyqit më të madh të demokracisë kundër diktaturës ishte shprehja më e qartë dalluese, mes sistemit barbar të vrasjeve në emër të popullit dhe sistemit demokratik të dënimeve në emër të ligjit. Thënë kjo e vërtetë e thjeshtë që njerëz të mirë e të ndershëm e harruan kur u turrën ndaj një avokati prej revoltës së tyre legjitime për plagën e hapur të Gërdecit, po vazhdoj më konkretisht.

Ne nuk e mbështetëm kandidaturën e Ardian Vishës për vendin në KLD as sepse ishte avokat i Fatmir Mediut, as sepse avokoi pafajësinë e ish-Ministrit të Mbrojtjes. Ky i fundit ka qenë, është dhe do të mbetet përgjithnjë i fajshëm për shpërdorim detyre me pasojë vdekjen e 26 njerëzve të pafajshëm, pavarësisht se kryefajtori është e do të mbetet kryeministri; pavarësisht se biznesin vrasës të Fabrikës së Vdekjes e hapi dhe e mbrojti deri në fund kryeministri; pavarësisht se gjykata e kapur nga pushteti i kryeministrit nxori të pafajshëm ish-ministrin për të nxjerrë të pafajshëm kryeministrin; pavarësisht se pafajësinë e Fatmir Mediut e shpiku gjykata e Saliut dhe nuk e fitoi Ardian Visha. Edhe vetë fakti që në fund fare, Fatmir Mediu nuk e votoi avokatin e tij, tregoi se ish-ministri i mbrojtjes ishte e mbeti një çirak i ustait të Fabrikës së Vdekjes.

Po ja pse e mbështetëm ne kandidatin që në fund nuk u lejua të garonte:

Së pari, mbështetëm një kandidat të pakorruptuar, i cili i ka shërbyer shtetit e ligjit në sistemin e drejtësisë dhe as nuk rezulton të jetë përzier në punët e ndyra të atij sistemi, as nuk është akuzuar ndonjëherë si prokuror, po edhe si avokat, për rryshfetllëqe e sekserllëqe. E mbështetëm përballë një kandidati tipik për moralin dhe sjelljen e kësaj qeverie. Një i verbër në shërbimin ndaj pushtetit, i përzier në historinë e turpshme të moskthimit e të moskompensimit të pronave tek pronarët pa taraf qeveritar, i dalluar në historinë e manipulimit të zgjedhjeve të 8 majit 2011 në Tiranë.

Së dyti, mbështetëm një kandidat me profil të spikatur profesional që as nuk ka rënë ndonjëherë në sy për mungesë profesionalizmi dhe as nuk është akuzuar, qoftë edhe nga kundërshtarët e kandidaturës së tij në tryezën e Komisionit të Ligjeve, si i paaftë për të kryer detyrën. E mbështetëm përballë një kandidati tipik për pushtetin që ka kapur shtetin, një guak intelektualisht, një i paaftë profesionalisht dhe i tejzellshëm politikisht. Shkurt një sojsëz i kompletuar për të kontribuar në qëllimin e mbrapshtë të kryeministrit për ta nënshtruar drejtësinë në çdo qelizë.

Së treti, mbështetëm një kandidat jopartiak për të synuar edhe vota përtej pakicës sonë parlamentare. Me këtë arsyetim: Të shfrytëzojmë qoftë edhe një mundësi teorike për të mos e lejuar pa bërë asgjë hiç në këtë rast, uzurpimin e pandalur të drejtësisë e të vetë KLD-së nga komandot antidrejtësi të Saliut.

Mes mospjesmarrjes në një garë e për pasojë, lejimit të vazhdimit të pushtimit pa asnjë "dhimbje koke" nga ana e kryeministrit të vendeve në strukturat kyçe të sistemit të drejtësisë, dhe një gare me sadopak gjasa për t'u fituar ne zgjodhëm të dytën. E për këtë zgjodhëm dikë me integritet e profesionalizëm jashtë sinorit të opozitës. Zgjodhëm Ardian Vishën jo sepse ishte më i miri i mundshëm dhe assesi jo pse nuk kishim kandidatë më të mirë brenda nesh. Po sepse asnjë kandidat i perceptuar mirëfilli si i yni s'do të kishte as edhe një shans teorik për të marrë më shumë se sa votat tona të pamjaftueshme. Ekranet dhe gazetat e Saliut vunë menjëherë tellallin duke bërtitur se opozita po testonte numrat në parlament në prag të zgjedhjes së Presidentit. E thanë ata nuk e thamë ne. E thanë sepse edhe ata e dine, siç e dimë edhe ne, faktin se shumica qeverisëse është në fazën kur mbingopja nga përfitimet prej pushtetit dhe leqendisja skandaloze e qeverisjes, kanë hapur të çara që vetëm zgjerohen dita-ditës brenda asaj shumice, e cila rri ende bashkë po është përditë e më pak e bashkuar. Rrjedha e procesit më pas, me presione, diversione, kërcënime të hapura brenda vetë shumicës për t'i shpëtuar disfatës së mundshme të votimit të fshehtë, e vërtetoi këtë pa lënë hije dyshimi. Por të vërtetën kokëfortë se Saliu nuk ka më shumicë të fshehtë në atë parlament ku votimin e fundit me kuti e ka lejuar të ndodhë në vitin 2007, na e tregoi neve dhe gjithë shqiptarëve rënia në shesh e rrobave të kryeministrit nga ku doli lakuriq, mu në mes të parlamentit, një vjedhës i rëndomtë votash. Sikur kishte zbritur vrik drejt e nga Ruzhdija famëkeqe dhe jo nga podiumi i qeverisë së Republikës së Shqipërisë.



Në foto: Kryetari i PS-së, Edi Rama *(poshtë)* **Deputetët e PS-së duke protestuar për votimin e anëtarit të KLD-së të enjten e kaluar**



U pa qartë se ofertat korruptive për deputetët e opozitës u zmbrapsën po aq turpshëm sa në kohën kur hienat e Saliut bridhnin me para nëpër thasë e çanta të pista, për të tërhequr në sallë deputetët opozitarë të rreshtuar në frontin e rezistencës demokratike gjatë 6 muajve të bojkotit parlamentar. Por u duk edhe më qartë se as presionet e kërcënimet mbi vetë deputetë të shumicës - e këta ishin më shumë se sa ata që edhe pse në shumicë e refuzuan hapur diktatin e tij të neveritshëm-nuk i mjaftuan Saliut për të ndenjur i patrazuar në majë të plehut qeveritar dhe për ta bërë krimin zgjedhor të radhës si gjithmonë me duart e të tjerëve. Prandaj kur plani për t'iu vënë shenja nëpër fletë të dyshuarve si deputetë brenda vetë radhëve të PD-së, dështoi me refuzimin e opozitës për të pranuar atë çka me trashësinë e vet monumentalisht të trashë, komisionerja Trashani e shprehu hapur si vullnet për të kontrolluar grupin e saj politik, Saliu bëri atë që s'e kishte bërë ende qysh kur ia nisi hajdutërisë elektorale në vitin 1996. Mori vetë personalisht rolin e kryetarit të "KQZ"-së parlamentare për t'i vjedhur votat drejtpërdrejtë me duart e tij. Iu turr i pari tryezës me fletët e votimit mu si ai huligani i famshëm i Ruzhdies që ka mbetur i fiksuar në kamerat e zgjedhjeve të vjedhura të vitit 2009. Dhe si komandant suprem i tërë votavjedhësve të 15 vjetëve të fundit, u ngjit edhe më lart se vetë Arben Ristani në shkallën e marrisë së dhunshme kundër lirisë së votës së fshehtë, duke dhënë kushtrimin për flakjen e kutisë e për kthimin e garës në një farsë të turpshme me një kandidat e me votë praktikisht të hapur. Sepse ato 71 vota që Jozefina i numëroi të enjten njësoj si Sudja kur firmoste lekët që nuk i kishte, kryeministri nuk i ka dhe nuk do t'i bënte dot kurrë bashkë, pa i çnjerëzuar në publik të tijtë aq brutalisht sa ç'i çnjerëzoi.

Kandidati i opozitës nuk u lejua të hynte në garë e prandaj edhe nuk fitoi. Ndërsa kryeministri nuk lejoi të kishte garë e prandaj edhe humbi. Humbi me turp duke turpëruar ende më shumë figurën kushtetuese që përfaqëson; duke turpëruar ende më shumë parlamentin që nuk përfaqëson vullnetin e zgjedhësve po fuqinë e vjedhësve; duke turpëruar ende më shumë shoqërinë tonë të dhunuar prej këtyre turpeve të njëpasnjëshme të qeverisë që kanë dërrmuar qelizat e moralit të saj; duke turpëruar ende më shumë vetë Shqipërinë, e cila në rrugën e mundimshme për t'u bashkuar me Europën u vu përsëri në pozitën e një vendi të penguar nga vija e sjelljes së kryeministrit të vet rrezikshmërisht qesharak.

E gjitha kjo ndodhi në vigjiljen e një testi jashtëzakonisht të rëndësishëm për provimin tonë të tretë të vjeshtës në Bruksel, siç është zgjedhja e Presidentit të Republikës, me votë të fshehtë e me kuti, ku Bashkimi Europian e Shtetet e Bashkuara si avokati më i madh i Shqipërisë europiane, presin nga palët një provë të pjekurisë politike e demokratike të vendit dhe në asnjë mënyrë një tjetër shfaqje shpërfytyruese për institucionin e Presidentit, të parlamentit e të votës së lirë. E gjitha kjo tregoi, pa asnjë ekuivok, se me shkallën e marrisë së dhunshme ndaj votës ku u ngjit kryeministri duke habitur edhe ata që nuk habiten më prej marrëzive të tij, jo vetëm prova që pret bota demokratike prej nesh në zgjedhjen e Presidentit është hëpërhë një iluzion, po edhe zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të jenë seriozisht të kërcënuara në lirinë e tyre nëqoftëse votavjedhësi i saposhfaqur i Ruzhdies mu brenda në parlamentin e Shqipërisë do të qëndrojë gjatë zgjedhjeve në krye të qeverisë, i maskuar nën rrobat e kryeministrit. E gjitha kjo paralajmëroi, si një demaskim ulëritës, të gjithë ata ende brenda shumicës së sotme që nuk duan të mbeten nesër në duart hakmarrëse e mbytëse të Sali Berishës, ashtu si edhe të gjithë ata jashtë shumicës së sotme nëpër tribuna partish e mediash, në rrugët e shoqërisë civile a të sipërmarrjes private, të cilët nuk duan të përfundojnë pas një viti në honin e një makthi fashist pa zgjedhje, pa gjykata, pa media të pavarura, pa biznes të pakapur nga pushteti, se s'ka më kohë dhe as arsye për të mos bashkuar të tëra forcat pa asnjë dallim. Le të bëhemi të gjithë bashkë përpara se sa të jetë tepër vonë, kundër këtij regjimi të açikmaskarallëkut tanimë kur kanë rënë të gjitha maskat. Dhe le ta shtyjmë ditën për t'u dalluar nga njëri-tjetri e për të kritikuar njëri - tjetrin nga pozicione të ndryshme, pas rivendosjes së rendit demokratik.

Abuzimi me peshoret, Çelmeta e inspektorët në gjykatë

Ish-kandidati për deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim Roland Celmeta dhe pesë inspektorë të tjerë të Drejtorisë së Meterologjisë pranë Ministrisë së Ekonomisë, janë marrë të pandehur dhe aktualisht dosja në ngarkim të tyre i ka kaluar gjykatës së Tiranës. Gjashtë të pandehurit akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kryenin çertifikimin fiktiv të njësive matëse (peshoreve), kundrejt shumave të parave që varionin nga 150 deri në 300 mijë lekë të vejtra. Veç Roland Çelmetës, mes të pandehurve janë dhe shtetasit Kristaq Thanasi, Armand Xhika, Dhurata Merlika, Muisi Musabelliu dhe Sokol Lami. Ata akuzohet për një sërë veprash penale duke filluar nga "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën" e deri tek ajo e "Mashtrimit". Gjatë hetimeve të kryera nga njësia hetimore Task-Forcë, është arritur të provohet se janë rreth 5 raste kur zyrtarët e Drejtorisë së Meterologjisë, kanë kryer veprime abusive. Ndërkohë që bizneset që përfitonin nga kjo skemë ishin pikat e karburanteve, furrat e bukës dhe qëndra të tjera tregtare.

Flet Dashamir Uruçit, bashkëshorti i ish-ministres së Kulturës

"Ndëshkoni vrasësin e gruas, Esmeralda"

Autori i aksidentit shëtit i lirë rrugëve të Shqipërisë




Në foto: Dashamir Uruçi dhe gruaja e tij, Esmeralda Uruçi

TIRANE

ELTON QYNO

vijon nga faqja 1

...duke mos u arrestuar nga prokuroria e Tiranës. Bashkëshorti i të ndjerës, Dashamir Uruçi thyen heshtjen, duke folur rreth rrethanave të ndodhjes së aksidentit si dhe mos marrjes të asnjë qëndrimi nga ana e prokurorisë për personin që në 17 dhjetor i goditi me makinën e tij nga prapa, teksa burrë e grua ishin duke u kthyer nga qyteti i Durrësit për në Tiranë. Në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" Dashamir Uruçi tregon se në momentin e aksidentit ai ka humbur ndjenjat, ku pasi është përmendur e ka parë vetën në krahët e disa personave, të cilëvë u ka pohuar se brenda, në makinën që ndodhej e rrëzuar në kanal kishte dhe bashkëshorten e tij Esmeraldën. Ai tregon se personi që i shkaktoi aksidentin u largua menjëherë nga vendi i ngjarjes, duke mos i dhënë as edhe ndihmën e parë. Sipas Uruçit, ky njeri vashdon të



Makina ku u aksidentuan bashkëshortët Uruçi

Vdekja

Esmeralda Uruçi ndëroi jetë në 21 mars në pavijonin e Neorokirurgjisë në QSUT ku ishte shtruar prej dy ditësh. Diagnoza që i vunë mjekët e këtij spitali ishte "Meningjit Purulent".

Esmeralda përballoi kohën e gjatë të qëndrimit në tokë, e lagur dhe e pambuluar, në pritje të ambulancës, e cila vonoi shumë

bëjë jetën e tij të lirë dhe të qetë, edhe pse bashkëshortja e tij Esmeralda Uruçi humbi jetën në mënyrë të pafajshme.

Zoti Uruçi, mund të na tregoni se si ka ndodhur aksidenti tragjik?

Më datën 17 dhjetor 2011, rreth orës 16:15 pasdite, kam qenë duke u kthyer nga Durrësi për në Tiranë. Kisha shkuar për të marrë bashkëshorten time Esmeraldën, e cila jepte mësim në universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit. Gjatë kthimit, pasi kam kaluar Vorën, diku pranë kompleksit "Elezaj", kam dëgjuar një goditje të fortë, direkte nga pas dhe menjëherë pas kësaj kam humbur ndjenjat. Pas disa minutash, e kam parë veten në këmbë, të mbajtur nga 2 djem të rinj dhe kam kuptuar se çfarë kishte ngjarë. Kam bërtitur duke u thënë njerëzve se në makinë kam edhe gruan. Disa udhëtarë të cilët nuk i kujtoj tani, e kanë gjetur shoqen time Esmeraldën, pa ndjenja, të rënë në kanal buzë rrugës ku kishte thithur shumë ujë. Ndërkohë, Esmeraldën e kanë vënë buzë kanalit ku i është dhënë ndihma e parë, frymëmarrja artificiale, nga një mjeke e re Pneumologe, Jola Klosi, të cilës familja ime do t'i jetë mirënjohëse përjetë. Me frymën e saj, Esmeralda përballoi kohën e gjatë të qëndrimit në tokë, e lagur dhe e pambuluar, në pritje të një ambulance, e cila fatkeqësisht vonoi shumë.

Kush jua dha ndihmën e parë gjatë aksidentit?

Ndërkohë, në vendin e ngjarjes kishte ardhur shefi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë Krenar Ahmeti, i cili në kushte të jashtëzakonshme organizoi dërgimin tim dhe të Esmeraldës në Spitalin Ushtarak në Tiranë. Gjej rastin që këtë njeri të mirë e specialist të aftë të Policisë Shqiptare ta falenderoj publikisht. Fati e solli që në spital të ndodhej Prof. Misha Kërci, i cili e përcaktoi menjëherë diagnozën dhe e futi Esmeraldën në një trajtim mjekësor intensiv. Në këto kushte, e intubuar, ajo ka qëndruar në reanimacionin e Spitalit Ushtarak nga 17 dhjetori deri më 23 dhjetor 2011. Të nesërmen e kemi dërguar urgjentisht me avion drejt spitalit "AKH" të Vjenës.

Pas aksidentit tragjik policia ka bërë ekspertizën në vendin e ngjarjes. Në dijeninë tuaj kush është shpallur fajtor i këtij aksidenti ju apo shtetasi Artan Kotarja?

Jam vënë në dijeni të ekspertizës të bërë nga një oficer i policisë dhe për fat të keq nuk jepet përgjigje asnjë prej problemeve të aksidentit. Për rrjedhojë pas një hetimi të tillë të përciptë nuk mund të përcaktohet fajtori. Në këto kushte, prokuroria e Tiranës ka urdhëruar riekspertimin, i cili do të bëhet nga 3 ekspertë shqiptarë.

Momentalisht hetimet ndaj shtetasit Kotarja në çfarë faze janë?

Aksidenti tragjik

Aksidentuesi u ndalua 24 orë

TIRANE

Shtetasi Artan Kotarja, që aksidentoi në dhjetor 2011 ish-ministren e Kulturës Esmeralda Uruçi, u la i lirë vetëm 3 ditë pasi kishte goditur makinën e çiftit Uruçi. Në 21 dhjetor gjykata vendosi të linte të lirë shtetasin Kotarja, duke bërë që hetimet ndaj tij të vazhdonin në gjendje të lirë pas asnjë masë sigurie. Sipas të dhënave policore automjeti me targa TR 6058 K ka goditur makinën e bashkëshortëve Uruçi, të cilët po udhëtonin me makinën me targa TR 8580 J. Dy bashkëshortët Uruçi qëndruan disa javë në spital derisa mjekët konfirmuan largimin e rrezikut ndaj tyre për shkak të aksidentit. Menjëherë pas këtij aksidenti të rëndë Policia e Tiranës arrestoi si autor të krimit shtetasin Artan Kotarja. "Nga veprimet hetimore paraprake rezultoi se, mjeti Benz veturë me targë TR 6058 K i drejtuar nga



Gjykata e Tiranës

shtetasi Artan Kotarja duke qarkulluar nga Vora në Tiranë ishte përplasur me mjetin tip veturë "KIA" me targë TR 8580 J, të drejtuar nga shtetasi Dashamir Uruçi. Pas përplasjes së këtyre dy mjeteve, mjeti me targë TR 8580 J, përfundoi në kanalin anësor të autostradës, dhe për pasojë u aksidentuan shtetasit Dashamir Uruçi dhe bashkëshortja e tij Esmeralda Uruçi"-thuhej në komunikatën e policisë. Sipas saj, pas ngjarjes automobilistike i arrestuari Artan Kotarja u largua nga vendi i ngjarjes dhe më pas, rreth orës 02:45, të datës 18 dhjetor 2011 u dorëzua pranë Njësisë për Kontrollin e Autostradave, ku dhe është bërë arrestimi i tij në flagrancë në orën 03:00 të mesnatës. Në lidhje me automjetin e bashkëshortëve Uruçi nga këqyrja e vendngjarjes ishte parë "një mjet veturë me targa TR 8580 J e markës "KIA", e përmbysur në kanalin anësor jugor të rrugës, e mbështetur në skarpatin jugor të kanalit me pjesën e pasme të mbështetur në bllokun e betonit. Ndërkohë që më 21 dhjetor 2011, gjykata e Tiranës vendosi lirimin nga arresti për personin e ndaluar në lidhje me aksidentin e bashkëshortëve Uruçi.

Fitoi 32 milionë lekë nga aksidenti, pranga policit rrugor

Një punonjës i policisë së qarkullimit rrugor në Durrës është vënë në pranga pasi në bashkëpunim me dy persona të tjerë, kishte "sajuar" një aksident, duke përfituar më pas dëmshpërblim nga një agjensi sigurimi prej 32 milionë lekësh. Ka qenë një denoncim nga kjo agjensi e sigurimit të automjeteve pranë Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm që ka çuar në nisjen e hetimit. Në bashkëpunim edhe me Task-Forcën në prokurorinë e Durrës, është bërë i mundur zbulimi i kësaj praktike aksidenti të rremë, si dhe vënia në pranga e punonjësit të policisë rrugore, Ahmet Daci si dhe bashkepunetorit të tij Kreshnik Gjoka, ndërsa është shpallur në kërkim një tjetër person, emri i të cilit për aryse hetimi nuk bëhet i ditur. Punonjësi i policisë rrugore kishte "sajuar" përplasjen e dy automjeteve, duke përfituar me pas 32 milionë lekë nga shoqëria e sigurimit. Gjithçka është zbuluar kur njëri nga automjetet që sipas praktikës së rreme, rezultonte i shkatërruar nga aksidenti i sajuar, ka kaluar kufirin drejt Greqisë. Punonjësi i policisë rrugore akuzohet për "Shpërdorim detyre", ndërsa sekseri për akuzën e "Mashtrimit".



Policia arreston tre autorët e grabitjes së argjendarisë

Qytë kokës pronarit grabitet 500 gr flori

Ngjarja ndodhi afër sheshit "Avni Rustemi"


Lajmi

Tre persona të armatosur kanë arritur të grabisin rreth 500 gramë flori nga një argjendari ku dhe kanë plagosur lehtë administratorin e saj. Më pas grabitësit janë larguar me vrap, por janë ndjekur nga efektivat e policisë, të cilët kanë mundur ti arrestojnë dhe bllokojnë sasinë e floririt të vjedhur.

TIRANE

ELTON QYNO

Nuk kanë të ndaluar grabitësit në kryeqytët, pasi dje është rregjistruar grabitja e rradhës me armë, por fatmirësisht ka përfunduar me lëndimin e lehtë vetëm të pronarit të argjendarisë dhe jo me viktima. Për këtë ngjarje tre persona janë arrestuar nga policia e Tiranës, ku dy prej tyre janë arritur të ndiqen sapo kanë dalë nga ambjentet e argjendarisë së grabitur, ndërsa njëri është ndaluar rreth 40 minuta më pas. Sipas policisë së Tiranës të ndaluarit quhen Dorian Mema 18-vjeç, Rigels Leka 18-vjeç dhe Erjon Kola 20-vjeç. Kanë qënë efektivat e komisariatit nr.1 në Tiranë, të cilët në momentin e grabitjes së argjendarisë ndodheshin shumë afër vendin të ngjarjes. Sapo kanë vënë re përplasjen fizike të grabitësve me pronarin e argjendarisë shtetasin Pavllo Shkavra, një patrullë policie ka qëndruar, por pikërisht në këtë moment janë larguar me vrap autorët e krimit. Atyre u është bërë thirje të ndalojnë, por këtij urdhëri grabitësit nuk i janë bindur, duke u larguar me vrap. Në këto kushte, efektivë të komisariatit Nr.1 të ndihmuara edhe nga disa patrulla të tjera janë vënë në ndjekje të autorëve, të cilët ikën në rrugicat e zonës së "Pazarit të Ri" që ndodhet afër sheshit "Avni Rustemi" në kryeqytet. Pas disa minutash ndjekje, dy prej tyre janë arrestuar teksa ishin fshehur në një banesë, ndërsa autori i tretë është ndaluar 40 minuta më pas.



Njëri nga autorët e grabitjes



Bizhuteritë e sekuestruara

Keni marë kontakte me prokurorinë, çfarë ju thonë?

Ai që bërë krimin që ekzekutoi dy jetë njerëzish të pafajshëm vashdon normalisht jetën e tij, shëtit i lirë rrugëve të Shqipërisë, pi kafe dhe "bën hajgare". Ndërkohë bashkëshortja ime kalbet në dhe pa i patur hak as hile askujt në këtë dynja. Ajo grua qytetare, nënë dhe bashkëshorte shëmbullore, intelektuale e rendit të parë, zonjë e rëndë e Shkodrës, ka humbur jetën dhe nuk kthehet më. Ajo bukuroshe që rezatonte dritë dhe mirësi nuk do të jetë kurrë më pranë bashkëshortit dhe fëmijëve që e deshën aq shumë, pranë familjes e cila e vajton çdo ditë. Më 17 prill 2012 mbushin 4 muaj nga dita e aksidentit fatal, i cili i mori jetën shoqes time të paharuar Esmeralda Uruçit. Ende sot ne nuk kemi akoma një qëndrim nga drejtësia shqiptare. Megjithë vdekjen e saj unë nuk shoh akoma veprime konkrete dhe reale për dënimin e krimit. Në të vërtet shoh përpjekje për ta ftohur problemin, përpjekje për ta deformuar, shtrembëruar ngjarjen. Personalisht, kam konstatuar prekje të relievit tek vendi i ngjarjes si dhe mungesë vullneti për tu thelluar në karakterin e aksidentit. Thekso se njeriu që na goditi direkt nga pas e u largua për tu fshehur nga vendi i ngjarjes, la dy persona në gjëndje të rëndë dhe nuk pati burrërinë tu jepte as ndihmën e parë, atyre që i goditi për vdekje. Megjithëse aksidenti pasqyron një goditje të pastër nga pas me një mori shkelje të tjera të njohura nga policia e prokuroria, autori u la i lirë brenda 24 orëve, a thua se kishte plagosur rëndë dy pata dhe jo dy jetë njerëzish, absolutisht të pafajshëm. Paradokse të drejtësisë shqiptare, të cilat do të kenë ndikime negative dhe në brezat që do vijnë. Sido që të jetë, ruaj ende besimin tek njerëzit që hetojnë çështjen e bashkëshortes time. Do të bësoj gjithashtu edhe tek ata që do ta gjykojnë nesër këtë çështje. Aktualisht me prokurorinë kam marrëdhënie korrekte. Kam kërkuar nga drejtuesit e saj që për çështjen time e të bashkëshortes Esmeralda të aktivizohen dhe prokurorë të vjetër e me eksperiencë të gjatë në punë dhe jo vetëm prokurorë të rinj. Duke patur parasysh se si pasojë e aksidentit fatal ka vdekur një grua, një nënë dhe një qytetare e pafajshme unë dhe familja ime e dëshirojmë shumë edhe vëmëndjen, e kujdesin e zonjës Prokurore të Përgjithshme Ina Rama.



Prokuroria e Tiranës

Ju ka ndihmuar ekonomikisht ndonjë nga institucionet qeveritare për transportimin dhe kurimin e bashkëshortes tuaj në spitalin Austriak?

Janë pikërisht institucionet shqiptare, pra qeveria shqiptare ajo që krijoi të gjitha mundësitë për transportimin dhe kurimin e Esmeraldës në spitalin "AKH" të Vienës. Në gjithë këtë procedurë delikate dhe urgjente më ndihmoi personalisht zonja Liri Berisha, një grua e mrekullueshme. Ajo u interesua personalisht per bashkëshorten time Esmeralda Uruci. Ajo do të ketë gjithmonë nderimin, dashurinë dhe respektin e fëmijëve e të krejt familjes time.

PLAGOSJA E ARGJENDARIT

Grabitja është rregjistruar në orën 11:00 të paradites së djeshme ku në argjendarinë që administrohet nga shtetasi Pavllo Shkavra, tre persona dy prej të cilëve të armatosur kanë hyrë në ambjentet e saj, ku nën kërcënimin e armëve kanë arritur të marin rreth gjysëm kilogram flori. Sasia e floririt të grabitur përbëhej në bizhuteri të ndryshme si unaza, varëse, ora etj. Grabitësit pasi morën bizhuteritë kanë tentuar të dalin, por janë kundërshtuar nga pronari i argjendarisë i cili ka mundur të kapë njërin prej tyre, duke tentuar ti heqë maskën. Njëri prej autorëve që mbante në dorë një pistoletë "Minibloë" e ka goditur me qytë në kokë shtetasin Pavllo Shkavra duke sjellë rëzimin e menjëhershëm në tokë të tij. Pas largimit të tre personave, disa nga patrullat e policisë janë vënë në ndjekje të tyre, ndërkohë që një patrullë tjetër ka transportuar me shpejtësi në Spitalin Ushtarak pronarin e argjendarisë. Mjekët thanë se nga goditja me qytën e pistoletës, ai ka pësuar vetëm një dëmtim të lehtë në kokë dhe se aktualisht sipas tyre pronari i argjendarisë gëzon shendet të mirë.

HETIMI PËR GRABITJET

Pas ndalimit të tre autorëve të grabitjes së argjendarisë, policia e Tiranës tashmë ka ngritur dyshime se Dorian Mema, Rigels Leka, dhe Erjon Kola kanë kryer dhe grabitje të tjara me armë në Tiranë. Për këtë, specialistët e sektorit të vjedhjeve kanë filluar verifikimet nëse tre të ndaluarit kanë bërë dhe grabitje të tjera. Këto dyshime u ngritën pasi gjatë momentit të arrestimit të tyre, efektivat e policisë arritën ti sekuestrojnë maska, thika dhe doreza, materiale këto që sipas policisë përdoreshin nga autorët gjatë grabitjeve që kryenin. Ndërkohë që dy pistoletat tip "Minibloë" të sekuestruara në cilësinë e provës materiale i janë referuar Institutit të Policisë Shkencore për të parë nëse ato janë përdorur në krime si plagosje apo vrasje në kryeqytet.

Këmbimet valutore leku zhvlerësohet ndaj euros në treg

Euro u është rikthyer niveleve më të larta të kuotimit në tregun tonë valutor këtë javë. Monedha e përbashkët evropiane është forcuar vazhdimisht gjatë ditëve të fundit, duke arritur dje, në tregjet e këmbimit në kryeqytet, vlerën e 140.20 lekëve. Ndërkohë, dollari është blerë me 106.30 lekë dhe shitur me 106.60 lekë. Ekspertët e këmbimeve valutore shpjegojnë se forcimi i euros është pasojë jo vetëm e ecurisë së bursave, ku në këto të fundit monedha evropiane shkëmbehet me afro 1.32 dollarë, por edhe për shkak të rënies së dëgesave të emigrantëve. Gjithësesi, theksojnë ata, forcimi i euros është brenda niveleve të pritshme dhe nuk shënon asnjë thellim në kurbën e këmbimit valutor. Një euro më e fortë penalizon klientët e bankave që kanë marrë kredi në këtë monedhë, të cilët përbëjnë shumicën e kredisë për shtëpi apo biznes. Gjithashtu, i bën më të shtrenjta importet, si dhe rrit koston e qeverisë për pagesën e borxhit të jashtëm, të marrë në valutë. Avantazh kanë eksportuesit, norma e fitimit të së cilëve do të rritet.

BE e Këshilli i Evropës, alarm për korrupsionin

"Shqipëri, politika pastron paratë"

Europa orienton shtetin si të hetojë rastet

Lajmi

Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian kanë përgatitur një dokument orjentues se si mund të hetohen dhe të zbulohen raste të korrupsionit ndër politikanët shqiptarë dhe familjarët e tyre, që përfundojnë në transferta parash jashtë vendit

TIRANE

GENC KONDI



"PACA, Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri", përgatitur nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian

KUSH HYN NË PERSONAT E EKSPOZUAR POLITIKISHT

Figurat politike

- Kryetari i shtetit
- Kryeministri
- Ministrat dhe zëvendësministrat
- Anëtarët e Kuvendit
- Anëtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të larta të Gjyqësorit, me vendime përfundimtare
- Anëtarët e bordit të Bankës qendrore
- Ambasadorët, të ngarkuarit me punë
- Zyrtarët e lartë të forcave të armatosura
- Anëtarët e bordeve mbikëqyrës të ndërmarrjeve shtetërore
- Funksionarët e lartë partiakë

Anëtar i drejtpërdrejtë i familjes

- Bashkëshorti
- Partneri (një person, i cili, në bazë të së drejtës kombëtare, vlerësohet si i barasvlershëm me bashkëshortin)
- Fëmijët e bashkëshortit/partnerit
- Prindët

Bashkëpunëtor i ngushtë

- Partnerët e biznesit
- Individët me pronësi të përbashkët përfituese të një subjekti juridik, si dhe ata të cilët administrojnë apo kontrollojnë biznese ose marrëveshje që dihet se janë themeluar për leverdi të politikanit
- Këshilltarët politikë

Përhapja e korrupsionit në administratën shtetërore, por edhe në gjithë pjesëtarët e fushës së politikës në vendin tonë ka detyruar Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian që, në projektin e posaçëm, të titulluar "PACA, Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri", të përfshijnë edhe orjentime se si të menaxhohet risku i personave të ekspozuar politikisht në pastrimin e parave të pista.

RREZIKU

Sipas Udhëzuesit, individët, të cilët ushtrojnë, ose në të kaluarën kanë ushtruar, një funksion të spikatur publik në Shqipëri, mund të përbëjnë rrezik më të lartë të pastrimit të parave, sepse pozitat e tyre të pushtetit dhe të ndikimit mund t'i bëjnë ata të prekshëm ndaj korrupsionit. Më të cënueshmit përfshijnë figura të larta politike, si dhe zyrtarë të lartë në kuadër të degëve administrative, gjyqësore dhe ushtarake të shtetit. Të njëjtat rreziqe përfshijnë edhe anëtarët e drejtpërdrejtë të familjeve të tyre dhe personat e njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë të tyre, theksojnë ekspertët e BE dhe Këshillit të Evropës.

PERSONAT

Sipas Udhëzuesit, personat e ekspozuar, që mund të kryejnë veprimtari të pastrimit të parave në Shqipëri, janë kryetari i shtetit, kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat, deputetët, anëtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të larta të Gjyqësorit, që marrin vendime përfundimtare, anëtarët e bordit të Bankës qendrore, ambasadorët, të ngarkuarit me punë, zyrtarët e lartë të forcave të armatosura, anëtarët e bordeve mbikëqyrës të ndërmarrjeve shtetërore dhe funksionarët e lartë partiakë. Ndërkohë, rrezik të mundshëm përbëjnë edhe anëtarët e drejtpërdrejtë të familjeve të personave të sipërpërmendur, të tillë si bashkëshorti, partneri (një person, i cili, në bazë të së drejtës kombëtare, vlerësohet si i barasvlershëm me bashkëshortin), fëmijët e bashkëshortit/partnerit dhe prindët. Ndërkohë, shteti duhet të ketë kujdes edhe nga bashkëpunëtorët e ngushtë të politikanit.

HETIMI

Sipas këshilltarëve evropianë, procesi i hetimit duhet të lejojë të kuptohet se çfarë aktivitetesh kanë shërbyer si burim pasurie i një personi VIP të klientit dhe cila ka qenë origjina e fondeve të marra në fillim të një marrëdhënieje. Për të pastruar produktet e korrupsionit mund të përdoren të gjitha fazat e procesit të pastrimit të parave. PEP e korruptuar nuk ka të ngjarë t'i vendosin fondet e pastruara në llogarinë me emrin e tyre ose në pronësi të tyre, ose në bashkëpunim me kompani apo ndërmarrje, lidhja me të cilat mund të vërtetohet lehtë.

Si shenja kryesore duhet të konsiderohen lëvizja e fondeve të konsiderueshme, pa arsye tregtare, ose kur veprimet me llogarinë bankare janë të papajtueshme me veprimet të ligjshme ose të pritshme, veprimtari të shumta brenda pak kohe; kur origjina e pasurisë ose burimi i fondeve të klientit nuk mund të vërtetohet lehtë, sepse filli i auditimit është këputur qëllimisht, etj

Koncensionet

Fillon hetimi i kompanive të naftës

TIRANE

Qeveria ka marrë mbrapsht dekla rimet e bëra deri tani për "pamundësinë" e saj lidhur me kontrollin e aktiviteteve financiare të kompanive koncensionare që operojnë në sektorin e hidrokarbureve. Pas debateve publike dhe bërjes publike të skandalit se kompanitë koncensionare, të cilat merren me prodhimin e naftës dhe gazit në vend, prej tetë vitesh nuk paguajnë tatimfitimi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka nisur një auditim financiar ndaj tyre. Ajo çka po shikohet me vëmendje në këtë rast është zëri i shpenzimeve, ky dyshohet se spekulimi ka qenë më i madh. Ky kontroll




pritet të përfundojë në muajin maj, kur do të mësohet nëse dalin apo jo realisht me fitim kompanitë. Ky nuk është kontrolli i parë ndaj kompanive të naftës. Edhe pse zyrtarisht nuk bëhen të ditura konkluzionet e auditeve të mëparshme, duket se kontrollet kanë qenë selektive. Për vitin 2011, janë shitur rreth 900 milionë tonë naftë, vlera e të cilës arrin në 450 milionë dollarë. Drejtori i Agjencisë së Burimeve Natyrore Besjan Pesha tha se kompanitë i janë shmangur tatimfitimit, pasi, kur janë dhënë koncensione për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, që në vitin 1994, me anë të një ligji të posaçëm, parashikohej që koncensionarët të paguanin 50% tatimfitimi në buxhetin e shtetit, pasi të jetë rikuperuar kostoja e investimit fillestar. Që nga viti 2004, në treg janë katër kompani të mëdha, të cilat, deri më sot, nuk kanë paguar asnjë lek tatimfitimi, duke deklaruar se shpenzimet e bëra për investime kanë qenë më të larta se të ardhurat nga nafta. Ajo që nuk shpjegohet nga drejtori Pesha është pse një hetim të tillë nuk po e kryen autoriteti tatimor, që është më i specializuar për verifikimin e bilanceve, por Agjencia e Burimeve Natyrore. Megjithatë, nisja e hetimit përfaqëson një hap prapa nga ana e qeverisë. Pak ditë më parë, ministri Naço deklaroi se qeveria nuk i verifikon dot se sa të vërteta janë deklarimet e kompanive.



ZYRË AVOKATIE PËR TË RINJTË

Të rinjtë tashmë do të kenë mundësi të gjejnë përkrahje ose këshillim për një sërë problemesh. Kjo do të realizohet në zyrën e Avokatisë së të rinjve, e cila do të fillojë shërbimin në datën 1 maj 2012. E pranishme në këtë aktivitet zëvendës ministrja e Arsimit, Nora Malaj, u shpreh se kjo zyrë do të ndihmojë të rinjtë shqiptarë të orientohen në tregun e punës.



"PLAKAT" DERI MË 20 PRILL

Njihen ndryshe si "Plakat e Prillit", ku koha prishet dhe mban përgjithësisht shi. Megjithatë meteorologët parashikojnë se, ky mot i lagësht do të vazhdojë deri në datën 20 Prill. Nga ana tjetër duhet thënë se, temperaturat mesatare nuk janë të ulëta. Sipas legjendës, plakat nisin në datën 15 prill dhe vazhdojnë deri më datën 17 prill, por duket se nuk do largohen shpejt.

Imami Ahmet Kalaja: Bajramin do ta falim në bulevard

Xhamia te Namazgjaja sërish falemi në shesh

Forumi Mysliman: Nuk zgjidh kërkesat

Lajmi

Xhamia e re që do të ndërtohet te Namazgjaja nuk i zgjidh kërkesat e myslimanëve, për një xhami të madhe që të mbledhë ditën e Bajramit të gjithë besimtarët që falen në bulevardin kryesor. Pikërisht për këtë arsye ka nga ata myslimanë që mendojnë se do të ishte më mirë që kjo lulishte të mos prishej, por të qëndronte një shesh falleje.

TIRANE

ESMERALDA KETA



Besimtarët myslimanë duke u falur në bulevard

Projekti

Në vitin 2011 Edi Rama, zhvilloi një konkurs ndërkombëtar për kompleksin fetar që do të ndërtohej pas pallatit të Kulturës, por tashmë myslimanët e kanë hedhur poshtë, projektin dhe truallin dhe kanë vendosur që xhamia e re të ndërtohet te Namazgjaja.

Myslimanët, edhe pas ndërtimit të xhamisë së re, do të vazhdojnë ta falin bajramin në bulevardin kryesor të Tiranës. Kjo pasi xhamia e re, siç e quajnë ata dhe jo xhamia e madhe, nuk do të mund të presë të gjithë atë valë të madhe besimtarësh që i drejtohen sheshit kryesor në këtë ditë të shënuar për fenë myslimane. Madje ka edhe nga ata skeptikë, brenda besimtarëve myslimanë, që mendojnë se prishja e lulishtes të Namazgjasë për të ndërtuar një xhami, e cila prapë nuk përmbush kërkesat e besimtarëve, është një veprim i pamenduar mirë nga komuniteti Mysliman. Ata propozojnë që ky shesh të qëndrojë një faltore e hapur, ashtu siç ka edhe emrin Namazgja, dhe mundësia për ndërtimin e një xhamie të madhe dhe kompleksi të madh mysliman të shikohet në zgjatimin e bulevardit të ri të Tiranës. Por ata që guxojnë të flasin hapur janë shumë të paktë. Ahmed Kalaja, imami i xhamisë "Dine Hoxha" në Tiranë na thotë se xhamia e re nuk do të mund të zgjidhë problemin e faljeve në bulevardin kryesor, por ai shton se ai nuk mund të japë një mendim nëse është më mirë që Namazgjaja të rrijë një shesh i hapur falleje, apo mbi të ndërtohet një xhami. "Unë nuk mund ta them këtë gjë. Ky është një vendim i rëndësishëm që duhet konsultuar me të gjithë myslimanët, por ndërkohë komuniteti Mysliman ka angazhuar ekspertët e saj për të zgjidhur këtë çështje. Unë nuk mund të them nëse kjo është mirë, apo nuk është mirë pasi nuk jam specialist. Sa i përket faljes në bulevard, ne do të vazhdojmë të falemi aty se nuk ka xhami që të marrë 60 mijë besimtarë që vijnë atë ditë për të bërë faljen e madhe", - na shpjegon imam Ahmed Kalaja. Thuajse të njëjtin mendim ka edhe sekretari organizativ i Forumit Mysliman Shqiptar. Roald Hysa na shpjegon se çështja që Namazgjaja mos të prishet për të ndërtuar një xhami, por të ruajë funksionin e saj të parë të saj, pra një shesh falleje për besimtarët myslimanë, është një ide e hedhur shumë herët. "Megjithatë unë nuk mund të them cuila është më mirë, një xhami e re apo që Namazgjaja të rrijë ashtu siç ka qenë. Ky është nj vendim i rëndësishëm. Por gjithashtu mund të them se xhamia që do të ndërtohet aty, nuk do të mund të ketë aq shumë sipërfaqe,sa që të mund të mbledhë të gjithë besimtarët që ditën e bajramit dalin në sheshin kryesor të Tiranës për t'u falur", - na thotë më tej ai.

Komuniteti Mysliman

Mësohet se lulishtja e Namazgjasë, që ndodhet te parlamenti, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar xhaminë e madhe të Tiranës. Për këtë arsye, komuniteti Mysliman ka hyrë në negociata me pronarët e tokës nga ana e shtëpisë së Ushtrisë, për të blerë një pjesë të truallit, por duket se çmimi ka qenë tepër i lartë. Megjithëse për këtë pikë nuk është gjendur ende një zgjidhje, komuniteti Mysliman e ka zgjidhur çështjen se kush do e ndërtojë xhaminë e re të Tiranës. Në komisionin e posaçëm të ngritur në bashkinë e Tiranës, ata kanë shpjeguar se projekti i xhamisë së re duhet të përshtatet me truallin e ri ku do të ndërtohet, si dhe të reflektojë trashëgiminë kulturore shqiptare në dizajnin e saj. Komuniteti Mysliman ka shpallur fitues kryearkitektin Muharrem Hilmi Shenalp, me një veprimtari 28-vjeçare, i cili ka ardhur në Shqipëri dhe është njohur me truallin e Namazgjasë. Myslimanët kanë deklaruar se ai ka projektuar xhami të ndërtuara në shumë vende të botës, si në Tokio, që në 2002 është shpallur një ndër ndërtesat më të mira të saj, në Berlin, dhe në Këln.

BRIGITTE BARDOT

Ndaloni vrasjen e qenve

Vrasjet e qenve nga bashkia e Prrenjasit është kritikuar edhe nga aktorja e famshme franceze, Brigitte Bardot. Në një letër të hapur, ajo i ka kërkuar kreut të kësaj bashkie, t'i japë fund kësaj metode barbare të vrasjes së qenve të rrugës. " Z. kryebashkiak, jam e tmerruar të mësoj se ju po bëheni gati të vrisni ca pak qen rruge në qytetin tuaj. Si mund të merrni një vendim të tillë kur ju keni detyrime morale dhe etike ndaj qytetarëve tuaj dhe fëmijëve të tyre? A mendoni se këto lloj aktesh do zgjidhin problemin e 'qenve rrugaçë' dhe do tregojnë një vizion prestigjioz për atë që po bëni me pushtetin tuaj? Nga ana tjetër, sterilizimi do shmangë riprodhimin dhe do i bëjë ata të përshtatshëm për të jetuar në komunitetin tuaj, njerëzit do kujdesen për ta, jam e sigurtë për këtë. Ju kërkoj të bashkëpunoni me shoqatën ARA dhe t'i jepni qytetit tuaj një reputacion humanizmi dhe menaxhimi racional të popullatës së qenve, jo t a prishni atë me zbatimin e një praktike skandaloze që do të ndikojë mbi imazhin e përgjithshëm të Shqipërisë", - shkruan aktorja e njohur në letrën e saj.

Reagon Bashkia

Tregtarët e Tiranës, protestë për taksat

TIRANE

Të pakënaqur për taksat e larta që i duhet të paguajnë, tregtarët e Tiranës kanë protestuar dje kundër kryebashkiakut Lulzim Basha. Pjesëmarrjen e tyre në këtë protestë nuk e kanë penguar as kushtet jo të përshtatshme atmosferike që kanë shoqëruar ditën e djeshme. Të shqetësuar nga kërcënimi me taksa që po u bëhet çdo ditë e më shumë të gjithë bizneseve të kryeqytetit, ata kanë preferuar që dalin në një tubim protestues që në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Një grup prej tyre kanë hedhur parulla kundër bashkisë së Tiranës dhe kryebashkiakut Lulzim Basha tek tregu çam dhe në disa zona të tjera. Ata kanë denoncuar rritjen e taksave, duke u shprehur se bashkia i gënjeu. "Basha na gënjeu !", "Ulni taksat !", "Mbajeni fjalën e dhënë!", ishin disa nga parullat e hedhura në protestë. Menjëherë pas kësaj situate të krijuar, në protestë kanë shkuar përfaqësues të Partisë Socialiste, me në krye kryetarin e grupit të PS në këshillin bashkiak, Aldrin Dalipi, që kanë dëgjuar nga afër shqetësimin e tregtarëve. Partia Socialiste dhe Dalipi kanë denoncuar të parët kamuflimin dhe mashtrimin me taksat të Bashës, duke pretenduar uljen e 60 taksave dhe kthimin e tyre në një të vetme. Por, në total taksa e vendosur është më e madhe se ajo që paguanin më parë. Dalipi i bëri thirrje nga sheshi Bashës që të tërhiqej nga kjo nismë që dënon tregtarët dhe të ulë taksat. "Partia Socialiste i bën thirrje kryebashkiakut me procedurë që të ulë taksat ashtu siç ka premtuar dhe të mos mashtrojë tregtarët", - ka deklaruar Dalipi. I menjëhershëm ka qenë reagimi i bashkisë së Tiranës. Spekullimi për përfitim politik nuk i shërben askujt. Koha kur bizneset nuk i paguanin në Bashki, por ua jepnin nën dorë inspektorëve tatimore ka marrë fund", - ka deklaruar dje zyra e shtypit e bashkisë së Tiranës.



Protesta e tregtarëve dje

Mbijetesa në Veri


UDHËTIMI *dëshpërues me misionarët katolikë që takojnë banorët një herë në muaj. Zona ku mungojnë mësuesit, rruga, energjia elektrike dhe transporti për prodhimet blegtorale*



Dy vajza në fshatin Xhan



Banorët e fshatit Xhanit duke u falur në kishë



Ipeshkvia në Xhan dikur, sot shkollë

Dukagjini, parajsa natyrore

Rruga Shkodër-Dukagjin, vuajtja e banorëve dhe privimi nga zhvillimi

DUKAGJIN


SIMON SHKRELI

Në 07:00 të mëngjesit u takuam me Markun, shoferi i cili së bashku me At Joaqiunin e bën rrugën e Dukagjinit në çdo stinë një herë në muaj. Me festën e Pashkëve rikthehet edhe shpresa për banorët e zonës së Dukagjinit. U nisëm nga Shkodra në drejtim të Dukagjinit, At Joaquini e nisi lutjen për një rrugë të mbarë dhe menjëherë pas rreth 20 minutash, përballesh me një pamje të mrekullueshme, një frymëzim që të vjen nga kjo luginë e quajtur Lugina e Kirit e cila në historinë e egzistencës së saj ka njohur vetëm dhimbje dhe vuajtje për çdo banor të zonës. Pas 22 km rrugë me asfalt pjesa tjetër është rrugë e cila vetëm e tillë nuk mund të quhet. At Joaquini tregon se i pëlqen shumë kjo zonë, ndjen një dashuri të veçantë edhe për njerëzit që jetojnë, por, siç pohon ai, ka mungesë të kujdesit dhe ndodhet shumë larg zhvillimit ekonomik, për çka ndjen keqardhje të madhe. Pas shkëputjes nga qyteti i Shkodrës dhe fshatrat e Komunës Postribë, fshati në kufi mes Dukagjinit dhe komunës është fshati Prekal, nga ky fshat për rreth 26 km të tjerë duhet të përshkohet aksi rrugor më i rrezikshëm në të gjithë territorin e Shkodrës. Kilometrat në këtë segment rrugor të rrezikshme, të trishtë dhe të bukur ecin shumë ngadalë. Rruga të ngjall trishtim kur kujton viktimat e 2007-ës që humbën jetën në ujërat e ftohtë të Lumit Kir, e sot kujtimi për ta ka mbetur i gdhendur në një pllakë guri, ndërsa rruga mbart mbi vete mallkimin e shumë familjeve të Dukagjinit. Pas rreth një orë e gjysëm udhëtim mbërrijmë në vendin e quajtur Guri i Mashës, në fshatin Kir të Komunës Pult të Dukagjinit, aty është kryqëzimi i rrugëve për në fshatrat Xhan, Plan, Pog dhe Kir. Komuna Pult e Dukagjinit përfshin 7 fshatra Kir, Xhan, Plan, Pog, Mgullë, Gjuraj dhe Bruçaj.



Aleksi 12 vjeç

Pulti është një zonë mjaft e njohur, Principatë Ilire, e më vonë edhe qendër Ipeshkvnore, duke qënë bartësi kryesor i ruajtjes dhe shpërndarjes së fesë katolike gjatë pushtimit osman. Sot kjo zonë jeton në gërmadhat e Principatës së harruar, tek e cila në kohë dhe periudha të ndryshme kanë gjetur strehë fise të ndryshme. Tek Guri i Mashës takohemi me Motër Sandra Bartolotto, murgeshën katolike, e cila që në vitin 1998 punon si misionare në zonën e Dukagjinit, e quajtur ndryshe edhe "Famullitarja". Rruga shumë e vështirë çahet lehtësisht me "Range Roverin" që e nget motra Batolotto. Ajo na sqaron se për në fshatin Xhan rruga kalohet lehtë edhe pse dëbora e ka dëmtuar shumë. Marku e nis makinën nga Guri i Mashës e më tej, gjatë këtij rrugëtimi të lodhshëm, por plot bukuri natyrore shtëpitë në gjithë këtë zonë duken të shpërndara, shumë larg nga njëra-tjetra, sa që të krijohet përshtypja se fshati shtrihet në një territor të gjerë.



Në foto: Mark Kadarja


Rruga është shumë e vështirë, kujdesi i shoferit është maksimal. Zbresim ngadalë në breg të Lumit Kir, sipas banorëve të zonës në vendin e quajtur tek "Ura" e ndërtuar në vitin 1998 nga misionarët italianë, lartësia mbidetare është rreth 200 metra. Pas rreth 20 minutash ecje ngjitemi ngadalë dhe takojmë njerëzit e parë. Motër Sandra, e cila kishte marrë me vete edhe një thes me miell e dorëzon atë tek një shtëpi. Ajo këtu është murgeshë, mjeke, mësuese dhe famullitare. Pali, një djalë 17-vjeçar nga Xhani tregon se ka kryer vetëm 9 klasë, kjo pasi nuk ka mundësi për të kryer të mesmen, sepse sistemi arsimor për të mesmen nuk i ofrohet kësaj zone, ndërsa udhëtimi deri në qytetin e Shkodrës është i vështirë dhe pamundur për të. Në pamundësi për të zgjeruar njohuritë e tija edhe më tej, pavarësisht dëshirës së madhe, e vetmja mundësi që i ofron ky fshat i varfër është të kujdeset për kafshët e shtëpisë dhe punë të tjera të rëndomta. "Nuk kemi ndonjë punë të madhe, sepse mundësitë janë të vogla. Shkollën s'e vazhdova se s'kam lekë, me çfarë ta vazhdoj? Shokë pak kam këtu se kanë ikë të gjithë prej këtu, asht vështirë me jetue në këtë vend", tregon Pali.



Rruga të ngjall trishtim kur kujton viktimat e 2007-ës që humbën jetën në ujërat e ftohtë të Lumit Kir, e sot kujtimi për ta ka mbetur i gdhendur në një pllakë guri, ndërsa rruga mbart mbi vete mallkimin e shumë familjeve të Dukagjinit.

PRIFTI, VIZITORI VETËM

Në majë të kodrës në lagjen Doçaj është godina që dikur ka shërbyer si qëndër e Ipeshkvisë së Pultit, ndërsa sot ajo shërben si shkollë e fshatit. Janë rreth 13 nxënës nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, me vetëm një mësues. Mbërrijmë tek Kisha, dhe aty takojmë Petritin së bashku me dy banorë të fshatit, ato ishin njoftuar se sot do kishte meshë në këtë fshat. Ardhja e priftit një herë në muaj është vizita e vetme që i bëhet këtyre zonave. Petriti shprehet se gjatë verës fshati rritet për nga numri banorëve të cilët



Misionarët katolikë

"Alpet të mahnisin, por duhet edhe zhvillimi ekonomik"

Takim me njëri tjetrin, një ritual i përmuajshëm në këtë fshat", kështu e cilëson At Joaquini meshën në këto zona. "Janë zona të mrekullueshme, por mungon zhvillimi ekonomik. Kujdesi ndaj këtyre banorëve është i vogël, mrekullohem sa herë vij këndej, cdo herë këto bjeshkë më frymëzojnë por edhe më trishtojnë! Banorët jetojnë në skamje dhe vështirësi të mëdha. Me gjithë këtë pasuri që ka kjo zonë e të jetohet në varferi është e rëndë. Por ngushëllohem sepse me gjithë varfërinë që e ka mbështjellë këtë zonë, banorët janë shumë të fortë shpirtërisht, të zotët për të përballuar çdo lloj sfide. Kjo është e radhë. Alpet e Shqipërisë më mahnisin, si Thethi apo Valbona, por duhet rruga dhe zhvillimi ekonomik", shprehet At Joaquin Fernandes. "Kam shumë dëshirë që gjithë kohës të jetoj në këtë zonë, por është e vështirë shumë. Këtu çdo gjë është e kufizuar" shprehet nga ana tjetër Moter Sandra Bartolotto.



Në foto: Motër Sandra Bartolotto *(djathtas)* At Joaquin Fernandes dhe harta e Shqipërisë ku tregohet vendndodhja e Dukagjinit





e harruar nga shteti



Në foto: Pllaka në Kishën e Xhanit

22-vjeçari, Nikollë Bubja: "Këtu mungon çdo gjë, fëmijët nuk kanë mësues, rruga është e shkatërruar, energjia elektrike është shumë e dobët, të vetmin burim jetese e kemi me kafshët, prodhimet e të cilave është shumë vështirë t'i shesim, sepse mungon transporti"

"Krenaria e tyre është për tu admiruar. Rradhë ndonjëherë ndodh që të vijmë këtu e të mos na thërrasin në shtëpi, siç ndodh edhe sot" thotë Marku.

"S'KA VOTA, S'KA INVESTIME"

Kristiani një djalë i ri nga mosha, shumë energjik, i mësuar me traditën e bujarisë dhe mikëpritjes, karakteristike për zonat e malësisë, na çon te shtëpia e tij. Nga maja e Kodrës së Doçajve e cila ndodhet në 1200 metra lartësi mbidetare, shihet e gjithë lugina e Xhanit, e cila nga njëra anë kufizohet me Malësinë e Madhe dhe nga ana tjetër me Shoshin dhe Shalën, dy zona të Dukagjinit. Aty zgjedhin të kalojnë muajt e nxehtë ne ajrin e pastër të maleve veriore, ndërsa dimri sjell ne këtë fshat përgjumje, vetmi dhe vështirësi të mëdha, ndërsa vizita e vetme që falin kënaqësi për këta banorë mbetet vetëm ardhja e priftit dhe e murgeshës: "Ky dimër ka qenë shumë i vështirë, ushqime kemi pasur. Kemi perparue mirëboll, mbasi shpëtueme gjallë e pa sëmundje", thonë banorët. Në këtë fshat deri në vitin 1990 kanë jetuar rreth 100 familje, vështirësitë ekonomike dhe shkatërrimi dalëngadalë i çdo objekti funksional në këtë zonë detyroi banorët të nisen drejt qytetit të Shkodrës dhe zonave fushore. "Këtu mungon çdo gjë, fëmijët nuk kanë mësues, rruga është e shkatërruar, energjia elektrike është shumë e dobët, të vetmin burim jetese e kemi me kafshët, prodhimet e të cilave është shumë vështirë t'i shesim, sepse mungon transporti", tregon 22-vjeçari Nikollë Bubja. Ai shton se: "Jemi munduar që të bëjmë një fushë futbolli, por s'ka kush të luajë. Të gjithë kanë ik. Shkollën nuk e kam përfunduar, s'kam asnjë prespektivë, vetëm të merrem me bagëtinë". Marku më tregon se sa herë që vjen në këto zona mbushet plot me energji pozitive, banorët janë të gjallë edhe pse me vuajtje të mëdha mbi shpatullat e tyre.



Në foto: Marku me dy prindërit e tij

takuam vëllain e tij më të madh Markun, i cili na sqaron se si e përballon jetën në këtë zonë: "Kam qenë emigrant në Itali, kam punuar në bujqësi dhe blegtori. Atje kuptova se bujqësia dhe blegtoria më kanë dhënë bukë edhe në vendin tim, kështu vendosa të kthehem. Nuk më mungon asgjë, mua e familjes time. Ekonomikisht jemi mirë. Unë brengosem shumë për shkollimin e fëmijëve të mi, dhe për rrugën e cila çdo ditë e më shumë po shkatërrohet. Këtu në këtë fshat përveç priftit dhe murgeshës nuk vjen asnjë njeri, ekzistojmë vetëm kur duhen votat që edhe ato i marrin në Shkodër, sepse atje janë shumica e banorëve. Këtu s'ka pse vjen kush për vota"! Sot në Xhan jetojnë rreth 30 frymë, shtëpitë e braktisura përgjatë gjithë luginës, shkatërrim i cili i përpinë dalë nga dalë bashkë me kohën, të kujtojnë tregimin e Skënder Drinit "I fundmi i Zotave", ku në një fshat të malësisë së mbi Shkodrës me rreth 50 shtëpi, kishte vetëm një banor, i cili çdo ditë i hapte dyert e banesave të fshatit, për t'i mbyllur në mbrëmje, me qëllim që të hiqte trishtimin e një fshati të braktisur. Marku, thotë se është zonë e bukur, por shumë e vështirë. "Jam mësuar me këtë rrugë sepse ka dhjetë vite që e bëj. Këtu çdo gjë është biologjike dhe e shëndetshme, por ka nevojë për infrastrukturë", thotë Marku.

TË BESOSH MË SHUMË MURGESHËN SE MJEKUN

Mark Kadarja, shoferi që na shoqëroi në udhëtimin tonë, punon për Caritas-in Dioqezan. Puna e tij është sa e bukur aq edhe e frikshme. Shtegtimi nëpër këto zona të ringjallin në kujtesë shkrimet e shenjta ku çdokush në momentet më të vështira të jetës jeton vetëm në shpresë të Zotit dhe të askujt tjetër. Por ndoshta kjo është e vetmja shpresë që këtë zonë e ka mbajtur të fortë, krenare dhe bujare. Pas shërbeses fetare nisemi për në fshatin Kir, zbritja nga kodra në drejtim të lumit është më e vështirë se ngjitja, pasi shtohet pesha e automjetit. Panorama e komoditetit që të ofron qytetit përballë panoramës së vështirë me të cilat përballen shqiptaret në zonat më të thella malore të çojnë tek një pyetje:"A ËSHTË EDHE KJO SHQIPËRI?". Në Kir ndeshim më shumë banorë, kjo për faktin se "rruga" kryesore e zonës së Dukagjinit përshkohet nëpër këtë fshat. Ngjitja deri tek Kisha është edhe më e vështirë, dëmtimet që ka lënë dëbora janë të mëdha çka shuan edhe shpresën se do ketë riparime të saj. Në oborrin e Kishës gjejmë rreth 50 persona, shumica gra dhe pleq, të cilët kanë ardhur për të marrë shërbesen e Zotit, por jo vetëm kaq. Motër Sandra kujdeset edhe për ilaçet e tyre, siç duket banorët e Kirit i besojnë më shumë murgeshës se sa mjekut, i cili një ditë në javë vjen në këtë zonë dhe kryen të gjitha vizitat. Karshi kishës së Zojës "Shën Premte", ndodhet godina e shkollës së fshatit dhe ambulanca. Godina e shkollës është tejet e amortizuar, pluhuri dhe papastërtia mbizotëron në çdo skaj të saj. Aleksi 12-vjeçar nxënës i kësaj shkolle tregon se mësuesit nuk vijnë rregullisht për të zhvilluar mësimin: "Unë dua të shkoj në shkollë, këtu janë shtatë mësues dhe vetëm 3 na vijnë, edhe ata një herë në javë"- thotë 12 vjeçari. Dimri ka qenë i vështirë për ta, trashësia e dëborës i ka kaluar 2 metrat, rruga është hapur me shumë vështirësi. Gjon Ndou, një tjetër banor i kësaj zone thotë "përgatitjet nuk i kemi bërë për një dimër kaq të eger dhe të gjatë". E ndërtuar me kontribut vullnetar, rruga Shkodër-Dukagjin, mbart mbi vete gjithë vuajtjet e banorëve të zonës dhe jo vetëm. Lugina e Kirit është ndër pjesët më të bukura, por e sigurt është vetëm nëse përshkohet në këmbë, është e ngushtë jo më shumë se 4 metra dhe pa asnjë mbrojtje. Zhurma e lumit Kir depërton përmes luginës qetësisht, një trajtshëm duke u bashkuar me qetësinë dëshpëruese të zonës. Teksa kthehemi me fuoristraden, e cila mjeshtërisht drejtohet nga Marku, rruga bëhët e padurueshme, e lodhshme dhe e frikshme. E lëmë pas zonen e Dukagjinit dhe në mbrëmje kthehemi në Shkodër në zhurmën dhe pluhurin e qytetit, sërish pas një muaji do jetë At Joaquini së bashku me Motër Sandrën që do i vizitojnë fshatrat që lamë pas.

Alpha Depozitë me Afat

Alpha SMILE është depozita me afat 3 mujor e cila ofron interesat më të larta: **6% në Lekë** dhe **4% në Euro**, me mundësi rinovimi edhe 3 herë të tjera me të njëjtin interes preferencial.

Gjithashtu ju ofron Komision **Zero** për transfertat në mbërritje në Euro.

Depozita më e mirë 3 mujore nga Alpha Bank.

Ne ju bëjmë të buzëqeshni 4 herë radhazi me Depozitën e re 3 mujore Alpha SMILE!

Interesat më të larta: **6%** në Lek | **4%** në Euro



Oferta është e vlefshme deri më 15 Maj 2012

ALPHA BANK

042 240 477 www.alphabank.al

ÇFARË FOLËN FATMIR GJATA E ANDREA VARFI. SI U PËRGJIGJËN ARAPI DHE KADARE?

Suplementi i së dielës te SHQIPTARJA.com

E-mail: rilindasi@gmail.com

RILINDASI

Viti II - Nr:15 E diel, 15 prill 2012 Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online
www.shqiptarja.com

SHKRIMTARET PARA DIKTATORIT

Dhori Qiriazi: Rrëfej takimin e poetëve me Hoxhën në '61

Admirina Peçi

Intelektualët, shkrimtarët dhe artistët që erdhën duke kapërcyer me zhurmë pragun e hekurt të diktaturës shqiptare, mund të thuhet pa drojë që e patën shpërthimin e tyre më të madh në fillimet e viteve '90-të. Në botimet e këtyre viteve, gjejmë kujtimet e trishta, dëshmi tronditëse, polemika për çështje të nxehta, për dosjet e spiunazhit, për angazhimin në politikë, për letërsinë dhe krijimtarinë që patën në diktaturë, për pretendimet e para për disidencë... e shumëçka tjetër e kësaj natyre, mjaft ngacmuese edhe sot. Të sjellësh atmosferën e botimeve të këtyre viteve, më shumë se dëshmi, përcjell një mentalitet, që erdhi duke u zbehur, duke ndryshuar e duke marrë një tjetër formë, përgjatë viteve 2000. Cikli i shkrimeve të zgjedhura të kësaj rubrike "Kujtesë" do ta zbardhë ende më qartë këtë metamorfozë, të mendimit, shprehjes, të të vërtetave apo 'zbukurimeve' të rastit në ndonjë histori. Në këtë prolog të kësaj rubrike, kemi zgjedhur një shkrim në formë kujtimesh të poetit Dhori Qiriazi i ndarë nga jeta në heshtje, e i tërhequr thuajse plotësisht nga skena e botimeve, në 2 tetor të vitit 2009.

Kujtimet e tij, botuar në "Revista letrare 5", lidhen ngushtë me fillesat e tij si poet, me atë orientim të hekurt që kërkonte të depërtonte në vargjet e tij dhe të poetëve të tjerë të brezit të Qiriazit, si Kadare apo Arapi. Dhori Qiriazi sjell në këto kujtime takimin që u zhvillua në Lidhjen e Shkrimtarëve në vitin 1961, mes Enver Hoxhës dhe një grupi shkrimtarësh.

Ai takim u shndërrua siç dëshmon Qiriazi në një përballje kritikash mes shkrimtarëve të brezit të vjetër dhe poetëve të rinj, mbi formën e poezisë dhe një frymë të re që po shfaqej në "vjershat e të rinjve"....

vijon në faqen 14-15



Në foto: (*Majtas*) Enver Hoxha (*Djathtas*) Tre poetët Dhori Qiriazi, Ismail Kadare dhe Fatos Arapi

"Si e nxorri Skiroi 'Buzukun' nga Shqipnija më 1949"

Hamdi Oruçi

Letra e Oruçit për Krujën

Palermo më 17.12.1952

Shkëlqesë,

Jam i sigurtë se do të kujtoheni se kush jam unë. Jam ai studenti sekretar i Studentenheim të Feldmuhlgaves në Vjenë. Kam qenë shok'i të ngratit Besim. Në këtë rasë fatkeqe Ju kam pasë dorëzue nji "resoconto" të plotë mbi zhvillimin e ceremonisë në krematoriumin e Vjenës, fjalimin e Z. Prof. Hupit e të mikut Dr. Ilhami Kryeziu.

Ndodhem tash 3 vjet gadi në Palermo, - mbas një pelegrimi në mbarë Evropën perendimore – për të krye studimet e fillueme në Vjenë, në degën...

faqe 20

Mithat Araniti, Përkthimi i rrallë i "Fjalorit etimologjik"

Si qëndroi i pluhurosur prej dekadash në bibliotekën e Durrësit vepra voluminoze prej 3 vëllimesh "Fjalorit etimologjik të gjuhëve indoevropiane", përkthyer nga gjermanishtja

Kolec Topalli

Para më shumë se 15 vjetësh, duke ndjekur botimet albanologjike në gjuhë të huaj, rashë në gjurmë të përkthimit të Fjalorit më të madh etimologjik të indoeuropianishtes, hartuar nga gjuhëtarët e shquar Alois Walde dhe Julius Pokorny. Përkthyesi i tij është intelektuali dhe miku i pandarë i letrave shqipe, përkthyesi i talentuar Mithat Araniti, emrin e të cilit e përkujtojmë sot me respekt të veçantë në 100-vjetorin e lindjes. Me të rënë në gjurmët e kësaj vepre, vrapova menjëherë në Durrës dhe e gjeta në bibliotekën e atij qyteti; sigurisht të pluhurosur, të harruar, të lënë mënjanë. Nuk di prej sa kohe dergjej atje kjo kryevepër e albanologjisë pa u kujtuar njeri as për veprën dhe aq më pak për përkthyesin e saj. Libri në fjalë, që përbëhet nga 3 vëllime, është nga më të vështirët. Përkthimi i tij nga gjermanishtja kërkon talent, njohje të mirë të dyja gjuhëve dhe kulturë të veçantë gjuhësore e jogjuhësore, cilësi që nuk i mungonin përkthyesit, i cili zotëronte 8 gjuhë të huaja. Se sa të vështirë e ka pasur ai të shqipërojë këtë libër, mjafton t'ju kujtoj se kur kisha punuar me botimin origjinal para shumë vitesh në Bibliotekën Kombëtare, më janë dashur disa ditë punë që të kuptoja kodet e tij shkencore, mënyrën e zbërthimit...

faqe 16



Kush është vullnetari në fotografi?

Kjo fotografi është bërë në Studion Walper të Bostonit. Nëse keni informacione për indentifikimin e këtij personazhi të "Gardës Civile" shruani në adresën tonë...

faqe 17

Ledi Shamku-Shkreli: Çabej si arkeolog i visareve gojore

Rreth librit me përmbledhje studimesh kulturhistorike të Eqrem Çabejt "Diana dhe Zana" shkruar në vitet 1934-1942, të parat shkrime në shqip pas studimeve në Austri

Admirina Peçi

Diana dhe zana" është një përmbledhje studimesh kulturhistorike të Eqrem Çabejt, botuar së fundmi në kolanën "Excipere" nga botimet Çabej, përgatitur nga Ledi Shamku-Shkreli. Këto tekste u shkruan e u botuan në pjesën më të madhe në vitet 1934-1942, fill pas kthimit të Çabejt nga Austria në Shqipëri më 1933. Janë sprovat e para të një vepre kulturhistorike, në të cilat synohet të shihet bota e kultura shqiptare në tërësinë e saj, gjuhë, doke e zakone, folklor, mitologji në suazën e gjeografisë e të historisë së popullit shqiptar. Këto rravgime në truallin tonë etnologjik autori i shkroi gjatë viteve që ishte mësues i shkollës së mesme në qytete të ndryshme të Shqipërisë, nga veriu në jug: Shkodër, Elbasan, Tiranë, Gjirokastër. Janë të parat tekste që Çabej shkruan shqip pas thuajse 15 vjet shkollim në Austri, në gjuhë të huaj.

Ndër këto studime të përmbledhura nën titullin "Diana dhe zana" përfshihen "Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare". Më tej vjen studimi "Zakone dhe doke të shqiptarëve", ku përfshihen: Familja dhe organizimi shoqëror; Lindja; Martesa dhe jeta bashkëshortore; Vdekja; Demonologji primitive dhe besëtytni, etj...

Më tej vjen studimi me titull "Kostandini i ...

faqe 18-19

KUJTIMET | POETI

vijon nga faqja 13

...Çfarë folën Fatmir Gjata e Andrea Varfi dhe si u përgjigjën Fatos Arapi dhe Ismail Kadare? Çfarë batutash shkëmbeu Hoxha me Kadarenë? Veç këtyre diskutimeve, ajo që ka vlerë sot përtej kujtimeve të Dhori Qiriazit është zbardhja e fjalës së plotë që mbajti Enver Hoxha në atë takim me shkrimtarët, ku duket se peshorja e tij anoi nga të rinjtë dhe vargjet e tyre të lira... Qiriazi dëshmon se tek kujtimet e diktatorit, kjo fjalë u botua me redaktime të shumta, duke lënë të kuptohej se nuk ishte fjala e plotë e Hoxhës edhe pse Qiriazi e cilëson: "...Vërtetë ka qenë një nga fjalimet më interesante dhe më të stërholluar të tij".



Në foto: Enver Hoxha

DHORI QIRIAZI:

Rrëfej takimin e shkrimtarëve me Enver Hoxhën në '61

Nga takimi i shkrimtarëve dhe artistëve me Enver Hoxhën në 11 korrik 1961

***

KUJTIME

Nga takimi i shkrimtarëve dhe artistëve me Enver Hoxhën në 11 korrik 1961

Afati i fletës kampit më mbaronte më 13 korrik, por unë, që kisha parë Sarandën, Himarën dhe viset e bregdetit, desha të qëndroj edhe pak ditë në Vlorë. Për këtë shkak u largova nga kampi i Dhërmiut tri ditë para afatit.

Zura vend në hotel, i qetë, dhe mendoja që të nesërmen të ngjitesha në Kusbaba. Më kishte zënë gjumi duke ëndërruar detin e pafund.

Pas mesnate, nën vegimet e turbullta të ëndrrës, më zgjuan. Tek koka e krevatit qëndronte një person i gjatë dhe pranë tij sportelisti.

Personi pyeti nëse isha ai që kërkohej dhe si u sigurua më tha:

-Nesër duhesh të jesh në Lidhjen e Shkrimtarëve. Biletën e autobusit e ke të rezervuar.

Mbërrita në Tiranë.

Zura vend në hotelin pranë Sahatit. Hapa valixhen dhe nxora që aty një limua të madh, të cilin e pata blerë pranë udhës në Lukovë. E preva dhe thitha pak lëng.

Ka qenë një nga fjalimet më interesante dhe më të stërholluar të tij ai i E.Hoxhës. Ky fjalim i 11 Korrikut 1961 është botuar edhe në veprat e tij me redaktime të shumta, por thelbi ka mbetur: "letërsinë do ta udhëheq Partia"



Në Lidhje më njoftuan se bëhej një mbledhje dhe asgjë më shumë. Natyrisht aty isha i ftuar.

Në këto vite ne kishim bërë shumë mbledhje për poezinë. Menjëherë më shkoi mendja tek libri im "Të fala botës", që më ishte kthyer para ca muajsh si i pabotueshëm.

Ky libër ishte cilësuar si pa shumë temë aktuale. Më tepër përmbante vargje meditative, vjersha dashurie dhe në fund kishte dy satira me temë sociale. Njëra kishte titullin "Mbreti Midhë" dhe tjera "Ime shoqe Çoko". Në këtë të fundit satirizohej jeta e varfër familjare e dy bashkëshortëve që s'kishin fëmijë dhe duhej të paguanin taksën e beqarisë. Taksë kjo e çuditshme, jo vetëm për atë kohë, por edhe për çdo kohë.

Në të parën kisha shkruar: "Ky mbreti i vjetër Midhë/ na ishte një gomar./ Çdo gjë të prekë deshi/ t'i kthehej krejt në ar./ Dëshirën ia plotësuan/ të lashtat perëndi/ çdo gjë që ai prekte i kthehej në flori./ Kështu ky mbreti Midhë/ të rronte s' ish kollaj./ I mjerë i uritur/na ra e vdiq pastaj/..."

Më vjen keq që një pjesë të poezive erotike të këtij libri tani nuk i kam, mbasi të vetmet kopje që kisha, ia dërgova një shokut tim të shkollës, Qani Çollakut, i cili nuk m'i ktheu më.

Disa nga ato poezi i kujtoj pjesërisht, disa u kujtoj vetëm titullin ose vargun e parë. P.sh. njëra kishte titullin latinisht: "*Procul oculis, procul cordis*"

Ç'u bënë? Kush mund t'i ketë?

Në njërën nga këto poezi thosha:

"I vetëm ikja në një të largët udhë,
pluhur i verdhë në çdo vend.
Të thirra ty, po rruga ishte shurdhë,
dhe hapësirat gëlltitnin emrin tënd..."

Doemos më ngacmonte shumë çështja e këtij libri me vargje që konsideroheshin të pabotueshëm.

Mbledhja ishte caktuar të bëhej në korpusin Qendror të Universitetit të Tiranës. Pak nga pak po mbushej njëra nga sallat e katit të dytë. Askush nuk më njoftoi se ç'ishte kjo mbledhje, megjithëse një pjesë e atyre që ishin aty duhet ta dinin që më parë.

Tek rrinim të ulur ndër banka, u hap papritur dera dhe hyri aty Enver Hoxha, duke iu drejtuar menjëherë Milto Sotir Gurrës që ishte në radhët e e para:

-Gëzohem Milto që të shikoj në këtë radhë!

Në çast fraza më bëri përshtypje dhe truri po më thoshte: Gëzohem që po të shoh në këto radhë, ku dhe mund të mos ishe… gë-


Në foto: Dhori Qiriazi


Në foto: Ismail Kadare


Në foto: Fatos Arapi

zohem që të shoh për jetëgjatësinë, gëzohem që....” Truri filloi të punonte.

Salla po mbushje pas tij me një numër njerëzish dhe të gjithë me pozita më të larta në Parti dhe në shtet.

Përkrah kisha Ismail Kadarenë me të cilin isha ulur në të njëjtën bankë dhe nga e majta, afër dritareve, ishte ulur Fatos Arapi. Gjithë-gjithë ishim tre nga më të rinjtë që shkruanim dhe që ishim thirrur aty të merrnim pjesë, mbase me doemos.

Aty për aty më erdhën ndërmend disa shënime që pata bërë mbi anën e bardhë të një diskutimi tim për poezinë, ku kisha shënuar inicialet e emrave të atyre diskutantëve, që kishin shprehur për mua mendime paradoksale dhe që tani, ja ku ishin, aty. Ata thoshin:

“me poemat jemi mirë, por me vjershat s’jemi mirë” (Vjersha shkruanin të rinjtë). Ose: “Ç’ janë këto poezi me tema intime?”. Pse shkruhen poezi me varg të lirë?”, “Figuracioni që përdorin të rinjtë, është shenjë e një romantizmi të vonuar?”.

Bëhej pyetja: “Ku është fryma e kohës?” d.m.th. pse mungon politizimi, pse ajo quhej frymë e kohës, etj.

Doemos, të gjitha këto duhet të kishin shkuar në vesh të udhëheqjes politike të vendit, e cila shtroi aty hapur kërkesat e saj duke bërë thirrjen: “Le të afirmohet secili në vargun e tij!” (pra, nuk ishte problemi te forma, por te brendia) por, ama, të afirmohet d.m.th. të jetë i pranueshëm, në radhë të parë prej udhëheqjes. Unë kështu e kuptova këtë thirrje.

Kjo ishte një kërkesë direkt politike dhe nga kjo nënkuptohej, nëse këta të rinjtë, me të cilët lidhen këto probleme të rrezikshme, nuk binden, nuk dëgjojnë, atëherë duhet konsideruar se kanë mbushur kupën dhe mund të bëhej edhe ndonjë kurban.

Ja pse kjo mbledhje ka qenë më e elektrizuara. Më seriozja, më tronditësja ndër ato që kam provuar në jetën time artistike.

Ndër diskutantët e moshuar, në s’gaboj, i pari e mori fjalën A. Varfi, i cili sulmoi formën e poezisë së re, vargjet e lira jo ritmike me të cilën shkruhej shpesh ajo dhe solli si shembull vargjet e Naim Frashërit nga “Bagëti e Bujqësi”, të cilat poezia e re duhet t’i kishte si model. E. Hoxha aprovoi Andrean dhe atij i ndriti fytyra sikur desh t’i thoshte vërtet sallës: “Flisni tani po të doni!”

Po kështu E. Hoxha aprovoi me kokë Fatmir Gjatën, i cili jo më kot theksoi përgjegjësinë partiake që duhet të ketë shkrimtari, e ka apo nuk e ka teserën e Partisë në xhep. Ai tha se po të vinte tani dikush e të përgjonte te dera, do të thoshte se kjo ishte një mbledhje Partie, pavarësisht se aty nuk ishin të gjithë komunistë.

Njëri pas tjetrit këto diskutime e qortime binin direkt, ose tërthorazi mbi kokën tonë, të rinjve.

Në intervalet e pushimit E. Hoxha u tërhoq në korridor, nuk buzëqeshte dhe pinte duhan. Ndërkaq nuk di sesi qarkulloi mendimi që duhet të diskutojnë edhe të rinjtë. Mbaj mend se, me ngutje i dhashë I. Kadaresë fletën e bardhë të kutisë së cigarave “Diamant” që kisha me vete. Ai shënoi atje disa pika.

Fjalën i pari e mori Fatos Arapi, i cili solli argumente për formën, mirëpo askush nuk shprehte, as aprovim, as disaprovim për ato që ai thoshte. Dukej sikur s’po i besonte njeri.

Pas tij foli Kadareja, të cilin E. Hoxha e priti me fjalët: “E kam lexuar atë që shkruan për Gjirokastrën dhe më ka pëlqyer”. Ai e kishte fjalën për një poemë për fëmijë që I. Kadareja kishte botuar atëherë, e cila kishte titullin “Princesha Argjiro”.

Në fillim Ismaili u duk se bëri një farë autokritike, por pastaj u hodh në sulm ndaj atyre që sulmonin formën, duke thënë: “Pse të mos i quajmë vargjet e matur vargje monarkikë, kur e dimë se ato kanë lindur në kohën e monarkisë?”

E. Hoxha qeshi.

Me sa duket kjo alternativë i dha fund problemit. Aty për aty E. Hoxha e mori fjalën vetë sikur të kish marrë një vendim:

“Në Seancën e parë unë i shkela syrin Andrea Varfit kur foli për Naimin dhe ai u kthye nga salla sikur desh t’ju thoshte: “Flisni tani po të doni!”. Por ja që ngrihen këta të rinjtë dhe gjejnë ca gjilpëra të holla… dhe s’ke se ç’bën..”

Pastaj vijoi:

“E vetmja gjë që s’ më pëlqeu këtu është ndarja në “të rinj” dhe në “të vjetër”. Ai kërkoi unitet për t’i bërë ballë revizionizmit Hrushovian që po na kërcënonte.

Në këto rrethana ai tha se i kishte dhënë dorën një bashkëqytetari të tij, Eqerem Çabejt, se një i burgosur politik që ishte liruar atëherë (emrin nuk po ia përmend, që të mos e përbuzin shokët e tij) kish dalë nga burgu dhe i kishte hipur autobusit dhe kishte parë gjithë Shqipërinë. Ai i kishte thënë se: “po ta merrnim ne pushtetin, këto vepra nuk do t’i kishim bërë as për 100 vjet”.

Për të na justifikuar ne të rinjve ai tha se nuk ishte kuptuar mirë raporti midis “traditës” dhe “novatorizmit”, ku nënkuptohej ajo që ishte raportuar tek ai kushedi se nga ç’ burime. Ai s’kishte përgatitur gjë me shkrim, fliste pa letër përpara dhe ishte në dorën e tij që t’ia jepte asaj mbledhje drejtimin si të donte.

Vërtetë ka qenë një nga fjalimet më interesante dhe më të stërholluar të tij.

Ky fjalim i 11 Korrikut 1961 është botuar edhe në veprat e tij me redaktime të shumta, por thelbi ka mbetur: letërsinë do ta udhëheq Partia”.

Ndaj konservatorëve servilë dhe të frikësuar ai vuri të rinjtë për balancim, duke synuar t’i afrojë.

Në këto rrethana ai e zgjidhi problemin në favor të të rinjve duke hedhur poshtë të vjetrit, në mënyrë që të dy palët të ishin të kënaqur, sepse duhej që të dy palët të luftonin për të njëjtin qëllim, për partishmërinë.

Rrija në vend dhe ndiqja me kujdes gjithçka, shumë i vëmendshëm dhe më dukej kotësi të flisja. Pse? Për mua çështja letrare s’kishte qenë kurrë një çështje vendi, s’kishte të bënte me probleme si këto. Për mua s’ kish rëndësi asnjë hierarki, asnjë pozitë.

Unë isha në antipod me zilinë letrare. Për një çast aty në sallë m’u duk vetja i huaj dhe kuptova që, edhe po të doja të flisja, s’ kisha pse të flisja.

Në vitin 1971 u botua një vëllim i imi në Kosovë. Për atë nuk u bë fjalë në shtypin tonë letrar dhe ai mbeti thuajse i fshehur. Pata fatin të kem një kopje të këtij libri dhe lexova pasthënien që kishte bërë kritiku Ali Aliu. Thuajse më kish lexuar mendimet që më kishin lindur dhjetë vjet më parë kur thoshte:

“Ky nuk çan kokën se përse e mbajnë të tjerët-për të parin apo për të fundit”. Ai dashur padashur, kishte thënë diçka thellësisht të vërtetë.

Kur dolëm nga korpusi i Universitetit të Tiranës, ecnim të tre (unë, Ismaili dhe Fatosi) pranë njëri-tjetrit në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe besova që edhe Fatosi e kishte ndjerë thellë rrezikun imediat, kur dëgjova që i thoshte Ismailit:

-Bëmë mirë që folëm! Bëmë mirë!....

Dhori Qiriazi

Një biografi

Dhori Qiriazi lindi në vitin 1933, në Lëngëz të Kolonjës. Ka mbaruar studimet në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Tiranë, në vitin 1958 për gjuhë-letërsi dhe histori. Ka punuar si mësues në qytetin e Ersekës dhe në fshatrat e Kolonjës deri në vitin 1988, kur doli në pension. Mban titullin “Mësues i Popullit”. Nga viti 2003 është anëtar i përjetshëm i Klubit “Bërns” (Irvine Burns Club), në qytetin Irvine në Skoci. Vdiq në Tiranë, më 2 tetor 2009. Disa nga titujt e veprave:



· Kur zemra rreh së pari (1958)
· Balada intime (1963)
· Poema e ushtarit (1968)
· Pishat me kristale (1971)
· Poezia shqipe (1974)
· Poezi (botuar në Prishtinë) (1976)
· Vitet (1982)
· Blerta (1981)
· Nekrasov, “Kush rron i lumtur në Rusi” (1982)
· Guri i kripës (1984)
· Kukuli dhe shigjeta (1986)
· Libri i këngëve – Petrarka (përkthim) (1995)
· Memorje – Gjon Muzaka (përkthim dhe pajisje me shënime) [1996]
· Gjauri, I burgosuri i Shilonit – Bajron (përkthim) (1996)
· Lirika Antike Greke, Antologji (përkthim) (1997)
· Dhimitër Kamarda, studim (1997)
· Poezi – Robert Bërns (përkthim) (1998)
· Kujtime mbi Tolstoin (përkthim) (1998)
· Kufoma e gjallë – L. Tolstoi (Dramë) (përkthim) (1998)
· Krishterimi në Shqipëri (2000)
· Baladat intime (ribotim 2001)
· Sheshi i Shatrivanit – S. Kuazimodo (përkthim) (2001)

...foli Kadareja, të cilin E. Hoxha e priti me fjalët: “E kam lexuar atë që shkruan për Gjirokastrën dhe më ka pëlqyer”

100-VJETORI | I LINDJES

Kolec Topalli

Para më shumë se 15 vjetësh, duke ndjekur botimet albanologjike në gjuhë të huaj, rashë në gjurmë të përkthimit të Fjalorit më të madh etimologjik të indoeuropianishtes, hartuar nga gjuhëtarët e shquar Alois Walde dhe Julius Pokorny. Përkthyesi i tij është intelektuali dhe miku i pandarë i letrave shqipe, përkthyesi i talentuar Mithat Araniti, emrin e të cilit e përkujtojmë sot me respekt të veçantë në 100-vjetorin e lindjes. Me të rënë në gjurmët e kësaj vepre, vrapova menjëherë në Durrës dhe e gjeta në bibliotekën e atij qyteti; sigurisht të pluhurosur, të harruar, të lënë mënjanë. Nuk di prej sa kohe dergjej atje kjo kryevepër e albanologjisë pa u kujtuar njeri as për veprën dhe aq më pak për përkthyesin e saj. Libri në fjalë, që përbëhet nga 3 vëllime, është nga më të vështirët. Përkthimi i tij nga gjermanishtja kërkon talent, njohje të mirë të dyja gjuhëve dhe kulturë të veçantë gjuhësore e jogjuhësore, cilësi që nuk i mungonin përkthyesit, i cili zotëronte 8 gjuhë të huaja. Se sa të vështirë e ka pasur ai të shqipërojë këtë libër, mjafton t'ju kujtoj se kur kisha punuar me botimin origjinal para shumë vitesh në Bibliotekën Kombëtare, më janë dashur disa ditë punë që të kuptoja kodet e tij shkencore, mënyrën e zbërthimit të fjalëve, në një fjalor që përfshin gjuhët që nga lindja duke nisur me indishten e persishten e deri me gjuhët kelte në Irlandë; që nga Veriu me nordishten e vjetër në Islandë, Norvegji e Suedi e deri në Jug me greqishten e latinishten. E gjithë kjo punë, sa e gjerë aq edhe e vështirë, e bën këtë fjalor më të mirin në fushë të indoeuropianistikës, më të besueshmin nga ana shkencore dhe më të përdorshmin në studimet etimologjike, një vepër që mund ta përkthente vetëm një personalitet i letrave me përgatitje të gjithanshme, jo vetëm nga ana gjuhësore, por edhe me horizonte shumë më të hapta, që lidhen me gjuhësinë dhe shtrihen në fusha të ndryshme të shkencës, të tilla si arkeologjia, etnografia, kultura materiale, folklori, letërsia etj. Dhe përkthyesi i kësaj vepre, që ishte arsimuar dhe edukuar në Austri, Itali e Kroaci, rrinte me ditë e me netë duke kuvenduar me Hahnin e Majerin, me Joklin e Krahen, me De Simonen e Prashnikerin, me Shuflajn e Shuhardtin duke dalë me mendjen e tij jashta qelisë së burgut për të hyrë në botën ilire, në vendbanimet mesape, në trojet etruske, në Europën e lashtë e në Ballkanin e trazuar, dhe nga këto vegime mund ta ketë shkëputur vetëm zëri i çjerrë i gardianit të burgut ose goditjet e çangës, që e thërrisin për apelin e përditshëm në kampin e internimit.

> **Përse u përkthye ky libër në gjuhën shqipe dhe përse nuk u botua asnjëherë? Është historia e njohur. Menjëherë pasi morën pushtetin në dorë, komunistët iu vunë punës për të krijuar kulturën e re marksiste duke mohuar pjesërisht dhe duke transformuar rrënjësisht atë që ishte krijuar në shtetin e mëparshëm shqiptar dhe në vendet perëndimore....**



Në foto: Mithat Araniti

MITHAT ARANITI

Përkthimi i rrallë i "Fjalorit etimologjik të gjuhëve indoevropiane"

Si qëndroi i pluhurosur prej dekadash në bibliotekën e Durrësit vepra voluminoze prej 3 vëllimesh përkthyer nga gjermanishtja

Përse u përkthye ky libër në gjuhën shqipe dhe përse nuk u botua asnjëherë? Është historia e njohur. Menjëherë pasi morën pushtetin në dorë, komunistët iu vunë punës për të krijuar kulturën e re marksiste duke mohuar pjesërisht dhe duke transformuar rrënjësisht atë që ishte krijuar në shtetin e mëparshëm shqiptar dhe në vendet perëndimore. U krijuan institute të reja shkencore, që do të mbusheshin me njerëz të rinj, besnikë të partisë-shtet, që në vend të diplomave të marra në ndonjë vend perëndimor, tundnin teserat e partisë. Këta përbënin falangat komuniste, që do t'i çirrnin maskën kulturës borgjeze për të krijuar kulturën e re proletare. Për këtë qëllim ishte e domosdoshme që veprat e botuara në perëndim të përkthesheshin, për t'u studiuar nga shkencëtarët e rinj të partisë, por të mos botoheshin, se çdo gjë perëndimore duhet të kalonte nëpër filtrin ideologjik të censurës komuniste. Për këtë qëllim u mobilizua një armatë të burgosurish politikë, që vuanin dënimin në burgje e kampe dhe të internuarish që dergjeshin në vende të izoluara dhe jetonin e punonin në këneta e moçalishta. Këta libra të përkthyer do t'u viheshin në dispozicion shkencëtarëve të rinj, disa të përgatitur në vendet lindore me të cilët na lidhte një miqësi e ngushtë, disa në shkollat tona. E në këto përkthime duhej shënuar ku fillonte e ku mbaronte faqja e origjinalit, me qëllim që shkencëtarët e rinj ta shfrytëzonin e ta citonin veprën pa e pasë lexuar e pa e pasë prekur origjinalin. Kjo ishte metoda komuniste e të bërit shkencë. Me këtë shpjegohet që shumë vepra të përkthyera nga ish të burgosurit e të internuarit ishin vetëm për përdorim të brendshëm, monopol shkencor, por ato asnjëherë nuk e panë dritën e botimit. E megjithëse kjo vepër u përkthye në gjuhën shqipe, për vetë fushën e vështirë që përfaqësonte, nga sa kam ndjekur botimet albanologjike, asnjëherë nuk është përmendur a cituar nga gjuhëtarët shqiptarë, me një përjashtim të vetëm, të Eqrem Çabejt, i cila ka punuar me origjinalin e kësaj vepre, si njohës i mirë i gjermanishtes.

Fati i Mithat Aranitit nuk është i veçantë, përkundrazi, ai shënon një fenomen, duke përfaqësuar dramën e hidhur të intelektualëve shqiptarë gjatë 50 vjetëve të regjimit komunist. Ndërsa shumë prej pseudoshkencëtarëve mbushnin radhët e institutëve studimore, intelektualët e vërtetë, ata që kishin mbaruar studimet në shkollat perëndimore, mbylleshin në burgje ose në kampe internimi dhe në rastin më të mirë kryenin rolin e përkthyesve anonimë në kushte jashtëzakonisht të vështira. E ndodhte që në një fabrikë tullash a pranë një furre gëlqereje kishte më tepër kuvendime me Homerin, me Danten, me Petrarken, me Arioston, sesa në institucionet tona kulturore e shkencore. Dhe kjo gjendje ishte tipar i kohës, karakteristikë e regjimit totalitar. Prandaj Mithat Araniti nuk ishte i vetëm. Ai kishte përkrah një elitë përkthyesish, shkrimtarësh, poetësh e shkencëtarësh, që nuk u pajtuan kurrë me regjimin komunist, si: Mirash Ivanaj, Mihal Sherko, Lazër Radi e shumë të tjerë,

me të cilët punoi, gjithnjë i heshtur, por gjithmonë i përkushtuar.

Pranë muzeve të Durrësit e Tiranës ndodhen mbi 250 tituj të dalë nga dora e tij, në vargun e të cilëve po lejohem të citoj vetëm disa: Russu: "Studime Ilirike", Krahe: "Gjuha e ilirëve", De Simone: "Gjuha mesapishte", Krahe: "Fjalor i emrave personalë ilirë të vjetër", Stipèeviè: "Ilirët, historia, jeta, kultura", Mayer "Gjuha e ilirëve të vjetër" dhe "Fjalor i relikteve gjuhësore ilire", Thalloczy "Kërkime iliro-shqiptare", Schuchardt: "Europa e vjetër. Zhvillimi i kulturave dhe popujve të saj", Papazoglu: "Onomastika dardane", Rendic-Miovcevic: "Lashtësia e gjallë. Studime onomastike ilire", Praschniker - Schober: "Fjalor etimologjik i indogjermanishtes" e shumë të tjera nga fusha të ndryshme të albanologjisë. Dhe cili qe shpërblimi i gjithë kësaj pune? I arrestuar bashkë me të jatin dhe të vëllanë në vitin 1944, disa ditë para të ashtuquajturit çlirim, ai qe ndër viktimat e para të terrorit komunist. Kaloi 10 vjet në burg, pastaj 7 vjet në internim dhe së fundi i dëbuar në vitet që i mbetën deri në vdekje. Fati i tij është i njëjtë, madje edhe më i rëndë se i shumë përkthyesve të talentuar, shkrimtarëve e poetëve, që nuk u pajtuan asnjëherë me regjimin totalitar komunist, që pranuan vuajtjet, burgun, internimet, por nuk u thyen dhe nuk e vunë pendën e tyre në shërbim të klikës rrenimtare.



Në foto: Kolec Topalli

Një fat i tillë ndoqi orientalistët e shquar, Mykerem Janina, Vexhi Buharaja e Tahir Dizdari, që të tre njohës shumë të mirë të gjuhëve perëndimore e lindore, të vjetra e të reja, filologë, përkthyes e transkriptues të shumë veprave me vlera shkencore e letrare. Mykerem Janina u burgos dy herë gjatë jetës së tij me akuzën stereotipe "për agjitacion e propagandë". Kaloi rreth 15 vjet në burgje e internime. Në burgimin e dytë ishte afër moshës 80 vjeçare.

Fat të tillë patën edhe helenistët, latinistët dhe përkthyesit e tjerë, faji i vetëm i të cilëve ishte se kishin studiuar në shkolla perëndimore dhe nuk pajtoheshin me diktaturën. Guljelm Deda, që Orlandon e çmendur të Ludovico Ariostos e bëri të flasë shqip, kaloi një jetë të tërë në burgje e internime, ai që për 17 vjet punoi për të përkthyer 40 mijë vargje të rimuara në gjuhën shqipe. Dhe kur u lirua, për të nuk kishte punë tjetër veç të thyente gurë në malin e Taraboshit. Këtë fat pati edhe Mark Dema, përkthyesi i talentuar i "Eneidës" së Virgjilit, dhe Veniamin Dashi, përkthyes i shumë veprave me karakter albanologjik nga studiuesit gjermanë. Edhe këta të shpërblyer me shumë vite burg dhe me anonimatin e përjetshëm.

Fatin e hidhur të Mithat Aranitit pati edhe një tjetër përkthyes e njohës i thellë i letërsisë klasike, Gjon Shllaku, që shqipëroi "Iliadën" e Homerit, veprat e Eskilit, Sofokliut dhe Euripidit, "Gjeorgjikët" e Virgjilit dhe "Këngët e Rolandit" të eposit francez, por u shpërblye me burg disavjeçar. Nikollë Dakaj, përkthyes i talentuar, poet e kritik letrar, pasi kaloi disa vite në burgjet komuniste, u detyrua të fitonte bukën e gojës duke punuar në fabrikën e tullave, atje ku mes gropave të baltës mund të gjeje njerëzit më të kulturuar të kohës.

Këtë fat pati edhe klasiku i fundit i traditës së përkthimeve greko-latine, që u nda prej nesh para para pak kohe. Pashko Gjeçi përktheu rreth 40 mijë vargje nga gjuhët klasike e moderne, duke na dhënë në një shqipe të pasur "Odisenë" e Homerit, "Faustin" e Gëtes, "Hamletin" e Shekspirit, "Andromakën" e Rasinit, poezitë e Leopardit e të Karduçit, dhe mbi të gjitha trilogjinë "Komedia Hyjnore", së cilës i kushtoi 20 vjet të jetës së tij. Dhe si shpërblim, u burgos që në vitet e para të vendosjes së diktaturës, duke vuajtur për disa vjet në burgjet e tmerrshme komuniste dhe në kampet e shfarosjes. Dhe shumë që hynë në këto burgje, nuk dolën të gjallë, por vdiqën burgjeve të Burrelit e të Spaçit, kënetave të Maliqit e të Bedenit ose në qelitë e errëta të sigurimit të shtetit.

Nëpër burgjet e diktaturës kaloi një pjesë të mirë të jetës edhe përkthyesi i talentuar në gjuhën frënge, Isuf Vrioni. Ai që bëri për vete edhe vetë francezët me përkthimet e tij në një frëngjishte elegante, kaloi 16 vjet në burgje e kampe shfarosëse, dhe kur doli s'andejmi, la në burg emrin e tij, që nuk mund të shënohej në asnjë libër, revistë a gazetë. Ishte i dënuar i përjetshëm edhe kur doli nga burgu i vogël në burgun e madh. Ai mbeti anonim deri në vitet '90. Disa të tjerë, si Martin Camaj, Arshi Pipa e Sami Repishti tentuan me rrezik të jetës dhe fituan lirinë duke dalë në Perëndim, por emrat e tyre mbetën të panjohur për një gjysmë shekulli në Shqipërinë komuniste.

Përkrah këtyre korifejve të kulturës shqiptare qëndron edhe personaliteti i letrave shqipe, Mithat Araniti, që për rreth 40 vjet përktheu vepra voluminoze shkencore, fjalorë, studime të ndryshme të dijetarëve të hershëm e bashkëkohorë nga të gjitha gjuhët e huaja që zotëronte, duke krijuar një fond të çmuar në arkeologji, etnologji, numizmatikë, ilirilogji, etimologji etj.

Kam pasur rastin një herë të vetme në jetën time të rri me këtë burrë të mendshëm e të urtë, atëherë kur pas një kalvari të gjatë e të stërmundimshëm u kthye posa gjallë në Tiranë në ditët e demokracisë, në një dhomë përdhese në rrugën Ali Demi. Edhe sot i ruaj të gjalla tiparet e tij të patjetërsuara: fisnikërinë e shpirtit, kthjelltësinë e mendimit të pjekur, karakterin e fortë, vullnetin për punë e modestinë, dashurinë për njerëzit e dëshirën për të pasur drejtësi; cilësi që njeriu ua lë si trashëgimin më të vyer pasardhësve.

Këtu po e mbyll fjalën time me një dëshirë: në enciklopedinë e re shqiptare jokomuniste emri i Mithat Aranitit të zërë vendin që meriton, duke u përjetësuar edhe në emrin e një shkolle ose të një rruge në vendin ku ka kaluar pjesën më të madhe të jetës, se personalitete të tillë janë elita e kulturës sonë, janë nderi i kombit shqiptar.

Të zbulojmë një gjurmë historike

Kush është vullnetari në fotografi?



Në foto: Ushtaraku, foto e të cilit ruhet në Qendrën e Studimeve Albanologjike

Kush është ky burrë në këtë fotografi? Historinë e tij dhe të një kostumi të rrallë e botuam numrin e kaluar në "Rilindasi". Por lexuesit mund të ndihmojnë në këtë rast për të identifikuar këtë personazh. Numrin e kaluar prezantuam shumë argumente shkencore, dokumente e analiza nga studiuesi Frederik Stamati, mbi kostumin e rrallë të një prej anëtarëve të Gardës Civile të Vartës, zbuluar në Tiranë. Së bashku me atë kostum u zbulua edhe kjo foto e rrallë. Kush e ka dorëzuar kostumin dhe fotografinë e tij? Nga mbrapa fotografia ka disa shkrime të studios ku është realizuar:

WALPER STUDIO
832 WASHINGTON ST.
BOSTON

Pra kjo fotografi është bërë në Studion Walper të Bostonit.

Studiuesi Stamati shpjegoi se pasi ka parë këtë fotografi kanë hapur kalendarin e Vatrës të vitit 1918. "U përqendruam në fotografinë që paraqet vullnetarët nga Bostoni. I vëzhguam me shumë kujdes, i zmadhuam. Ka nja dy ngjasime, ndoshta të rastit. As edhe laboratori i kriminalistikës nuk arriti të realizojë identifikimin e plotë me padurim. Ngulmuam më shumë, duke krahasuar fotografi të tjera… Ngjason në një fare mase me Aqif Përmetin… Mirëpo nuk mund të thuhet me siguri. Vallë, a do të mundemi ta identifikojmë këtë luftëtar që ka hyrë në botën e muzeut, në botën e përjetësisë.

Kush është ky luftëtar? Kush e njeh? Kush e ka në kujtimet familjare, për të cilat i a vlen të krenohet? Këtu ose në SHBA në arkivat e "Vatrës"? Ndoshta do të jetë një simbol. Emri dhe fotografia e tij i përkasin historisë po aq sa "Trupi Vullnetar", apo "Garda Civile". Ne nuk e gjetëm dot. Na e tregoni ju, në se keni mundësi! I shkruani gazetës ose Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë, ku ruhet ekzemplari i vetëm i uniformës së çmuar". Ky qe apeli i studiuesit Stamati dhe i gazetës. "Rilindasi" pret informacione në faqen zyrtare ne facebook, ose adresën rilindasi@gmail.com

LIBRI | STUDIMET

LEDI SHAMKU-SHKRELI:

Çabej si arkeolog i visaret gojore shqiptare

Rreth librit me përmbledhje studimesh kulturhistorike të Eqrem Çabejt shkruar në vitet 1934-1942

Admirina Peçi

Diana dhe zana" është një përmbledhje studimesh kulturhistorike të Eqrem Çabejt, botuar së fundmi në kolanën "Excipere" nga botimet Çabej, përgatitur nga Ledi Shamku-Shkreli. Këto tekste u shkruan e u botuan në pjesën më të madhe në vitet 1934-1942, fill pas kthimit të Çabejt nga Austria në Shqipëri më 1933. Janë sprovat e para të një vepre kulturhistorike, në të cilat synohet të shihet bota e kultura shqiptare në tërësinë e saj, gjuhë, doke e zakone, folklor, mitologji në suazën e gjeografisë e të historisë së popullit shqiptar. Këto rravgime në truallin tonë etnologjik autori i shkroi gjatë viteve që ishte mësues i shkollës së mesme në qytete të ndryshme të Shqipërisë, nga veriu në jug: Shkodër, Elbasan, Tiranë, Gjirokastër. Janë të parat tekste që Çabej shkruan shqip pas thuajse 15 vjet shkollim në Austri, në gjuhë të huaj.

Ndër këto studime të përmbledhura nën titullin "Diana dhe zana" përfshihen "Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare". Më tej vjen studimi "Zakone dhe doke të shqiptarëve", ku përfshihen: Familja dhe organizimi shoqëror; Lindja; Martesa dhe jeta bashkëshortore; Vdekja; Demonologji primitive dhe besëtytni, etj...

Më tej vjen studimi me titull "Kostandini i vogëlthi dhe kthimi i Odiseut", "Diana dhe zana", "Disa figura të besimeve popullore shqiptare" dhe "Një vështrim mbi folklorin shqiptar", ku Çabej trajton këto tema: "Mënyra e banimit dhe shtëpia", "Ushqimi dhe zakonet e mikpritjes", "Kujdesi i trupit dhe veshja", "Arti popullor", "E drejta popullore", "Mitologjia popullore", "Festat popullore" dhe "Poezia popullore".

Ajo që e grishi Eqrem Çabejn ndaj disiplinës që po zinte fill edhe në Europë, qenë studimet e paplota qoftë gjuhësore qoftë etnologjike që do duhej të vizatnin trajtat kryesore të identitetit tonë. E thënë me fjalë të tjera ai iu bashkua "modës" së gërmimit arkeologjik në visaret gojore shqiptare

Mbi disa detaje më të hollësishme rreth librit dhe autorit flasim në këtë intervistë me Ledi Shamku-Shkrelin e cila ka punuar me kujdes për mbledhjen dhe botimin e këtyre studimeve të veçanta të Çabejt.

Kolana Excipere, e ideuar dhe realizuar prej jush, është plotësuar së fundmi me një vepër mjaft interesante të Eqrem Çabejt "Djana dhe zana". Këto studime kulturhistorike i përkasin një periudhe të hershme të kontributit të Çabejt. Çfarë e grishi studiuesin drejt kësaj bote tejet të pasur me histori, personazhe, mite, legjenda...?

Kjo është një dritare e re që botimet "Çabej" hapin brenda kolanës "Excipere": botimet me natyrë etnolinguistike. Etnolinguistika është një disiplinë relativisht e re, e cila i ka rrënjët në studimet e kohës kur autori i shkroi këto sprova studimore, e ndoshta edhe ca më parë. Ajo çka tërheq vëmendjen tonë sot nga sa duket është edhe ajo çka tërhoqi vëmendjen e Çabejt rioshlidhja e gjuhës së vendit më kulturën e një rrafsh ende më të gjerë lidhja e kulturës sonë me ato të popujve rreth nesh apo ende më tej, lidhjet me popujt bri të cilëve rrugëtuan pararendësist tanë në ag të kohënave. Ndonëse Çabej i klasifikon këto ese nën termin "kulturhistori", ne i trajtojmë ato sot në suazën e etnolinguistikës, që është një përcaktim ende me specifik, pa i hequr përcaktimit të Çabejt gjerësinë e vështrimit. Nga bisedat që kam bërë me të bijën, zj.Çabej, sikurse vërehet edhe nga kushdo që njeh ndeshtrashën e mëpasshme të profesorit, del se ai ka pasur synim në atë kohë konsolidimin shkencor të trajtesave që merreshin me çështje të cilat vibronin mes antropologjisë linguistike dhe linguistikës antropologjike. Kështu, nëse vështrohet veprimtaria e periudhës nistore të Çabejt (mundemi edhe ta përcaktojmë këtë si Periudha e Parë e tij), del se thuajse të gjitha shkrimet e atyre viteve janë me natyrë kulturhistorike. Madje edhe doktoratura e tij, që së shpejti sheh dritën e botimit, është e kësaj natyre: "Shqiptarët në Itali" studion gjuhë e doke trashëgimore të Horës t'Arbëreshve ne Siqeli. Pra, në synimet për ta konsoliduar e për t'i bërë traditë këto trajtesa, ai bashkohet me Xhuvanin, Ashtën e të tjerë dhe hartojnë një nga më kërshëroret antologji titulluar "Bota Shqiptare". U prit me entuziazëm ky përthekim, madje Nikoll Gazulli e përshëndeti me një recension tek Hylli i Dritës botimin në fjalë. Duke u kthyer tek pyetja juaj, ajo që e grishi Eqrem Çabejn ndaj disiplinës që po zinte fill edhe në Europë, qenë studimet e paplota qoftë gjuhësore qoftë etnologjike që do duhej të vizatnin trajtat kryesore të identitetit tonë. E thënë me fjalë të tjera ai iu bashkua "modës" së gërmimit arkeologjik në visaret gojore shqiptare. Vetëm pak dekada më parë Gustav Meyer qe i pari që botoi një këngë nga Eposi i Kreshnikëve. Ish pra një botë e tërë për t'u zbuluar e marrë në shqyrtim: Bota Shqiptare. Ndoshta kështu është edhe sot. Në fushë të etnolinguistikës pak hapa janë hedhur ndër ne.



Në foto: Studiuesja Ledi Shamku-Shkreli

Cilat ishin interesat e tij, në këtë kohë, ngacmimet....?

Sikurse thashë pak parit, interesi i tij në këtë kohë nuk është gjuhësia e mirëfilltë, siç thotë Saussure "e shqyrtuar në vetvete dhe për vetveten", por vështrimi ndërsiplinor i të kaluarës e cila në mënyrë trashendentale shfaqej në trollin shqiptar sapo lije pas kufijtë e vegjël të qyteteve. Shfaqej hatashëm dhe shajniste! Ngacmimet natyrisht kanë qenë të shumta, qysh nga leximet e albanologëve të mëdhej e deri tek kontaktet e shpeshta me klerin françeskan, të cilët si elementë higroskopikë, ja kishin dalë të depërtonin në limfën e Shqiptarisë. E përfytyroj ngazëllimin e Çabejt të ri teksa zhytej në rrëfenjat e Donat Kurtit dhe Bernardin Palajt, "dy lypsarve me strajcë që u endën maleve të Shqypnisë me mbledhë xehet e kulturës sonë", apo në bisedat me nxanësa malësorë në kohën kur ai drejtonte konviktin "Malet tona" në Shkodër. Sikundër shtangej nga fanitjet përrallore të legjendave të Jugut gjatë vizitave të tij në

Çabej iu bashkua "modës" së gërmimit arkeologjik në visaret gojore shqiptare. Vetëm pak dekada më parë Gustav Meyer qe i pari që botoi një këngë nga Eposi i Kreshnikëve. Ish pra një botë e tërë për t'u zbuluar e marrë në shqyrtim: Bota Shqiptare. Ndoshta kështu është edhe sot. Në fushë të etnolinguistikës pak hapa janë hedhur ndër ne.





Në foto: Kopertina e librit "Diana dhe zana" *(djathtas)* Gjuhëtari Eqrem Çabej

vendlindje. Apo më vonë, në mbrëmjet e gjata pranë tryezës së bukës me Fatos Mero Rrapajn, çamin e ditur, qëmtues i thesarit të Çamërisë.

Çfarë sjellin për lexuesin këto tema kërkimore, kaq të gjera dhe të veçanta njëkohësisht?

Është e habitshme sa pak libra ka ende ndër rafte bibliotekash lidhur me këto tema. Është po aq e habitshme sa pak u intereson studiuesve sot thellimi në etnolinguistikë apo dhe në antropologjinë historike, ku gati-gati më i madh është interesimi i të huajve se yni vetë. Veç ndonjë studjues i motshëm dhe ndonjë ripërtypje materialesh të thëna njemijë herë, ndonjë regëtimë aty-këtu e asgjë më shumë. Shkollarët e rij – dhe këtu nuk flas për ata që i shohin me nënçmim e ironi këto shprehje "të vjetëruara etnike" – nuk mendojnë se orët e studimeve të tyre duhen harxhuar kësisoj. E them këtë me keqardhje, mbasi në Francë bie fjala, studimet e reja mbi Chanson de Roland nuk reshtin së argumentuari dhe hedhur poshtë e mandej ripropozuar këndvështrime të reja mbi trashëgiminë e vjetër. Çfarë i sjellin lexuesit - thoni ju. Besoj se i sjellin ngacmimin që krijon era e beharnave që vjen nga një guzhinë e mirë e që u nxit oreksin për të ngjëruar. Pa këto ngacmime lexuesi nuk do jetë i interesuar të kërkojë libra kësodore; e pa këtë kërkesë, studjuesit nuk do jenë të interesuar të ofrojnë rravgime shkencore mbi këto tema. Dhe ky bëhet një rreth vicioz që duket i vështirë për t'u hapë. Por unë them se tash mbramit diçka po ndryshon. Forumet e internetit, ku gjithnjë e më shumë të rinjtë ia hyjnë debateve mbi çështjet e identitetit, janë një tregues se libra të tillë do mirëpriten. E pastaj cikli i mësipërm, me t'u hapë ky rreth do vijojë të zgjerohet e të ofrojë njohje dhe qetësi. Pikërisht atë qetësi identitare që fal dija e mirëfilltë.

Pse "Djana dhe zana"? Ky është vetëm njëri nga argumentet e shkrimeve të studiuesit...

Kjo është një nga ato pyetjet e dobishme për të cilën thuhet: "Po t'mos qe, do duhej shpikur"! E po ashtu, në përgatitjen e këtij libri, argumenti i përzgjedhur ka qenë një nga dilemat e mija dhe të botueses, ndaj do t'i përgjigjem me rrëfim.

Kohët e fundit duket se ka një rizgjim të interesit editorial për etnokulturën tonë, e kështu janë botuar një tubë shënimesh dokesore, legjenda a rrëfenja, janë shqipëruar edhe shënime udhtimi nga shtegtarë të huaj. Porse çdo libër është në fakt libërshkruesi i vet. Ndaj edhe kjo përmbledhje e Çabejt, pas gjykimit tim, është krejt e veçantë në këtë "zahirë" albanologjie që përmenda, pikërisht se është konceptuar prej një shkencëtari – gjuhëtar etimolog, pra jo thjesht prej një mbledhësi të ditur a folkloristi. Gjithë këto shestime mbi doke, mbi besime e zota, të cilët shfaqen sekushi i përfaqësuar me apelativin a epitetin e vet, janë produkte të një gjuhëtari që i merr në vështrim ngaqë beson tek qëndrueshmëria e fjalës si dëshmia kryesore e qëndresës së etnisë. Beson madje se fjala është edhe më e qëndrueshme se guri. E kur fjala shqyrtohet si tregues qëndrese, gjuhësia vjen e na rendit fill një listë përfaqësimesh dhe këto janë: Hidronimet, Toponimet, Hieronimet, Teonimet, Patronimet dhe Antroponimet. Në këtë listë ka vërtet ndeshje mes gjuhëtarësh për të përcaktuar përfaqësimin më të rëndësishëm si dëshmitar kulturhistorik. Gazulli ngulmon tek hidronimet, Justin Rrota – i shkollës së Krahes – tek Antroponimet. Ka të tjerë që ngulmojnë tek Patronimet duke përligjur s'andejmi migrimet e mëdha të fiseve të lashta. Mesa kam kuptuar unë, Çabej shenjon shpesh si parake Toponimet e Patronimet – një dyshe në fakt e pazgjidhshme. Kështu, nga kjo listë e mësipërme, elementi që brendamban me shumicë përmbledhja jonë janë Teonimet – teonime ilire, romake, kelte, trake, helene – gjithë një panteon ku Diana dhe Zanat kanë shkallaren e vet. Ndaj dhe unë, nisur nga kjo listë, pikasa pikërisht Dianën dhe Zanat – këtë dyshe primordiale, që shenjonte njëherësh bashkim dhe veçanësim. Shqyrtimi i këtij dualiteti është një tjetër argument që dëshmon se etnikoni ynë ka marrë e ka dhënë shpengueshëm me fqinjët e përhershëm, pa e humbur asnjëherë thelbin e vet, e pikërisht këtë rend marrëdhëniesh them se ka dashur të zdritë edhe Çabej gjuhëtar. Ndaj edhe zgjodha ta hulumtoj më gjatë këtë dyshe, me dëshirën për t'u ofruar lexuesve një çelës modest leximi mbi thelbin e metodës dhe objektit të Çabejt.

> **Lufta, sikundër dihet, në Shqipëri ndryshoi shumë gjëra, dhe Çabej u gjend i detyruar të ripërcaktonte itinerarin shkencor që duhej të ndiqte, pa bërë kompromise në kurriz të së vërtetës. U detyrua të linte disi mënjanë, në favor të gjuhësisë së mirfilltë, orientimet etnolinguistike, didaktike apo ortografike të atëhershme**

E mandej, ky çift teonimik nuk del vetëm në syzimin me të njëjtin titull, por është pjesë e rëndësishme edhe një tjetër syzimi, kur Çabej shqyrton krej panteonin e zotave ilirë.

Ju thoni se këto shkrime ishin mbase grishja drejt një vepre që mbeti e papërfunduar.. Pse? Nëse do të vijonte më tej si do të qe rruga e kërkimeve të Çabejt në këtë fushë?


E shpjegova ca më lart. Ai po ndërtonte diçka me punën e tij po edhe me bashkëpunëtorë të kalibrit të lartë, për ngritjen në nivel disipline të studimeve të kësaj lënde. Por Lufta, sikundër dihet, në Shqipëri ndryshoi shumë gjëra, dhe Çabej u gjend i detyruar të ripërcaktonte itinerarin shkencor që duhej të ndiqte, pa bërë kompromise në kurriz të së vërtetës. U detyrua të linte disi mënjanë, në favor të gjuhësisë së mirfilltë, orientimet etnolinguistike, didaktike apo ortografike të atëhershme. Si do kish qenë rruga? Eeeeh, kush mund ta thotë këtë tash?! Ndoshta një përgjigje kësaj pyetje mund t'ia japim vetëm pasi të botohet e plotë trashëgimia e tij studimore e pastaj të analizohet nga kritikë e specialistë. Por një gjë mund ta themi: boshti qendror do të kish qenë gjithsesi gjuhësia. Rruga dhe përftesat mund të kishin qenë të ndryshme.

Megjithatë unë besoj se në njëfarë mënyre Çabej po e vijon rrugën e vet duke u takuar sërish me lexuesit shqiptarë në këto kohë kur riplazmohen ndërgjegje brezash. E kjo është edhe shortja që u bie gjithë të mëdhejve: të mos ndalen. Më vjen tash në mend thënia e një iluministi: "Ata që e kanë pikasur dritën para të tjerëve, janë të dënuar ta ndjekin pas derisa drita të fitojë!"

Ç'mund të themi për nuancat gege të gjuhës së Çabejt që bie në sy te këto shkrime?

Nuk janë nuanca gege në fakt. Në përmbledhje ka artikuj fund-e-krye në gegnisht. Çabej i ndoronte mirë të dyja koinetë, madje të trija, edhe arbërishten. Gegnishtja ishte gjuha e kohës në administratë, dhe Çabej qe veç tjerash edhe punonjës i administratës. Të mos harrojmë se gegnishtja ishte gjuhë e prestigjit jo vetëm kombëtar poedhe ndërkombëtar. Deklasimi i kësaj koineje do vinte vetëm pas Lufte. Por jemi në një rreth elitar njerëzish, të cilët shpesh për respekt ndaj sho-shoqit, përpos një dendizmi të kohës, iu drejtoheshin miqve në idiomën e tyre. E jo vetëm tosku Çabej shkruan në gegnisht. Kështu fjala bie, Mustafa Merlika krutan, debaton në toskërisht me Konicën për fjalën "ndoshta". Apo Anton Harapi e mban ligjëratën e vet përpara korçarëve të gjithën në toskërisht. Gjithë ky ndërkëmbim idiomash e shprehish bëhet për hir të më t'bukurës ndjesi që provon me bartë shpirti i njeriut, të dashurisë për kulturën dhe vlerat e veta identitare, apo për ta thënë si Buzuku "n'së dashtunit botës sanë". "Djana dhe zana" është përftesë e një dashurie të tillë: trashendentale e përherë të re.

LETRAT | E PANJOHURA



Në foto: Faksimile të dy prej faqeve të letrës së Hamdi Oruçit dërguar Mustafa Krujës në dhjetor 1952

HAMDI ORUÇI I SHKRUAN MUSTAFA KRUJËS

Si e nxorri Skiroi 'Buzukun' nga Shqipnija më 1949

Po ta kapnin komunistat kushedi ç'do i kishin ba. Aleksandër Xhuvani e dinte, por çudi si nuk ka ndërhy

Hamdi Oruçi ishte një i ri intelektual që studionte në vitet '50 në Palermo për mjekësi. Një atdhetar pasionant, ai kujdesej dhe i kushtonte vëmendjen maksimale botimeve e kërkimeve të fundit në fushën e gjuhës e kulturës shqiptare. Mik i afërt me djalin e Mustafa Krujës, ai i shkruan këtij të fundit, për të krijuar lidhje me një profesorin e tij në Itali, i cili kishte shumë dorëshkrime e një fjalor të stërmadh të shqipes gati për botim. Ai quhej Prof. Dr. Marco La Piana dhe kërkonte të binte në kontakt me Mustafa Krujën që të shkëmbente me të mendime gjuhësore.

Ndërsa flet për dorëshkrime që vetë studenti Oruçi i ka parë e i ka prekur, ai tregon edhe se si e ka parë të fotografuar gjithë veprën e Buzukut, të cilën Skiroi e ka marrë nga Shqipëri në vitin 1949. Por si mundi ta nxjerrë pa e vënë re komunistët dhe si nuk ndërhyri Aleksandër Xhuvani edhe pse e dinte këtë fakt?

Letra e këtij intelektuali drejtuar Mustafa Krujës (Merlika) në vitin 1952, i prin një letërkëmbimi të gjatë e të bukur me Merlikën, të cilin suplementi ynë do ta zbulojë javë pas jave. Letrat janë botuar për herë të parë në "Hyllin e dritës", ndërsa për lexuesin e gjerë i sjellim si më poshtë duke nisur nga ky numër, me lejen dhe kujdesin që ka treguar për këtë botim Eugjen Merlika.

Letra e Oruçit për Krujën

Palermo më 17.12.1952
Shkëlqesë,

Jam i sigurtë se do të kujtoheni se kush jam unë. Jam ai studenti sekretar i Studentenheim të Feldmuhlgaves në Vjenë. Kam qenë shok'i të ngratit Besim. Në këtë rasë fatkeqe Ju kam pasë dorëzue nji "resoconto" të plotë mbi zhvillimin e ceremonisë në krematoriumin e Vjenës, fjalimin e Z. Prof. Hupit e të mikut Dr. Ilhami Kryeziu.

Ndodhem tash 3 vjet gadi në Palermo, - mbas një pelegrimi në mbarë Evropën perendimore – për të krye studimet e fillueme në Vjenë, në degën e Mjeksisë. Shpresoj në të madhin Zot të mbaroj në Fruer të vitit 1953, d.m.th. mbrenda 2 - 3 muejve.

Këtu në Palermo jam në konviktin Saluto, bashkë me Spiro Mukën, të birin e z. Koços, e jemi të kënaqur. Para disa ditësh erdhi këtu për 2 - 3 orë Dervish Rexhepi, të cilin e priti Spiroja.

Mora vesht se Shkëlqesa e Juej jeni shumë përpara në shumë studime të gjuhës shqiptare, dhe bile më thonë se keni botue edhe nji abetare të gjuhës shqipe. Sa kishe dëshirë t'a shifshe e t'a kishje! Për fjalorin gjith'ashtu më thonë se e keni plotsue përsëri. Kam shpresë se këto janë të vërteta.

Kam marrë vesht gjith'ashtu se nji englez E. Mann, ka botue lexikun ma të madh të gjuhës shqipe në Londër, të cilin bilé e ka këtu Prof. Dr. Marco La Piana, por që unë nga nji influencë (flamë) nuk kam dalë ende me shkue me e pá. Z. La Piana, sikurse Ju siguri sht e dini asht nji studjoz i thellë i gjuhës sonë. Kam pa me sy punimet e tija. Habitet njeriu me guximin e këtij plaku të Ri i cili tash 40 e ma vjet punon ditë e natë e nuk mendon gja tjetër veçse çështje gjuhsore shqiptare. Ka gramatikën ma të plotë, aqë sa dij unë, e shumë të thellë. Nji dorëshkrim 1000 e ca faqesh. Gjithashtu fjalori i tij asht i gjanë. Ka, sikurse thotë ai, ma se 40.000 fjalë shqipe pa njoh fjalët turke, greke, sllave e të hueja përgjithsisht. Asht glotolog i përsosun njeh sa e sa gjuhë mistogermane. Ka teorina që unë qé besa nuk i njoh por që më habisin e më lanë me gojë të mbyllun me që kurrë nuk i kam ndigjue.



Në foto: Mustafa Kruja

Asht tue kursye tash sa vjet me ba nji shumë 1.000.000 £ për të botue diksionerin. I ka ardhë pak si keq se si E. Mann-i botoj para tij. I vëllaj i Prof. La Pianas asht edhe aji historian i thellë e si ordinar në Universitetin e Harward-it të Bostonit e punëve mbi historinë e Vatikanit për enciklopedin e Re amerikane. I vëllai tjetër; zengjin në Los Angeles asht edhe ai studjos në gjuhë. Familje italo – shqiptare me ndjenja shqiptare. Mu ba zemra mal kur ndigjova Prof. La Pianën e Harwardit të flasi italisht jo aqè mirë por shqip shumë mirë.

Të gjitha këto informata Ju apë sepse Z. La Piana Marco do të dëshroj me hy në korrispondencë me Shkelqesën e Juej, për çështje gjuhsore shqiptare. Unë kam ndërhye të filloj me botue diçka në Fletoren "Flamuri" [e me të vertet asht botue diçka] e në Fletoren "Shpipërija". Shpresoj t'i dalë në krye.

Më falni Shkëlqesë për guximin që marrë të Ju shkruej. E unë e dij se puna e parë e ne të rijëve asht të kryejmë studimet së pari, por gjaku na vlon e.... e ndërhyjmë ndoshta edhe në punë që s'dijmë se si t'i dalim në krye. Jam i sigurtë se Shkëlqesa e Juej e kuptoni shqiptarizmën t'onë. Të japim gjithshka Shqipnisë, dje në luftë, sot në studim e në ndihmesë e nesër po që nevoja edhe gjakun. E këtë që mendoj unë jam i bindur se e tanë rinija shqiptare e mendon e e thotë me gjithë mend e me gjithë zemër. E jam i bindur se edhe Shkëlqesa e Juej na besoni në sinqeritetin t'onë.

Për artikujt e Juej në "Albanie Libre" janë shumë interesant. Në ndonji pikë nuk jam dakord me Ju por me gjith'atë kam nderimin ma të madh për guximin e Juej për njohtësit e Jueja gjuhësore e historike. E përgëzimi i jem asht i sinqertë e nuk ka asnji sfond politik. E Ju në letrat shqipe duhet të zini vendin që meritoni.

Edhe një lajm që do të Ju pëlqej:

Kam pasë fatin e mirë të shoh të gjithë dorëshkrimet e Monsignor Skiros. Buzukun. Buzukun, Shkëlqesë, të fotografueme aqë bukur e nji komenti që të hap zemrën e të banë me e dasht ma tepër gjuhën shqipe e atdheun shqiptar. E ka professori i jem Dr. Zef Skirò i cili e ka prue nga Shqipnija më 1949. Sikur t'a shifshin komunistat se çka kishte në valixhe kushedi se çka do t'i bajshin. I qëlloj nji ignorant që e kontrolloj e kështu e shpëtoj. Por Aleksandër Xhuvani e dinte. E këtu asht për t'u habitë se si ky Kryetar i Dhomës Komuniste nuk ka ndërhy. Shumë dyshime.

Shkëlqesë,

Më falni sa Ju shkrova.

Kishe me dashtë një përgjegje nga Ju për korrispondencë me Prof. La Pianan e nji përgjegje për abetaren.

Ju uroj shëndet e punë të mbarë.

Hamdi Oruçi
79. Corso Pisani,
Palermo.
P.S.
Në këtë rast për shumë vjet Motin e Ri.
Qoftë mot shqiptar.

Dyqani VIP


NISMA E RE *Biznesmene, politikane, por edhe këngëtare e artiste dhurojnë rroba firmato të blera mijëra euro, të cilat shiten për 5 mijë lekë të vjetra*

Reportazh

ESMERALDA KETA


Pantallona "Ferre" që janë blerë 1300 euro





Dyqani i milionereve ja gratë që dhurojnë

Klientja: E fiksuar pas rrobave të këngëtares Jonida Maliqi

Roba firmato, të blera mijëra euro nga të pasurit e Shqipërisë dhe që shiten shumë lirë. Kjo e ka bërë një ndër butikët më të preferuar të Tiranës, por edhe sepse shitëset aty janë vërtet speciale. Herë mund të gjesh pedagogen e njohur të gazetarisë, Iris Luarasin, e herë të tjera mund të të shërbejë edhe zëvendësambasadorja e SHBA në vendin tonë, Deborah Jones. E gjitha për një qëllim bamirësie: të ndihmojnë gratë e dhunuara. I hapur vetëm në fundjavë, dje dita ka qenë paksa më e qetë për "Women we love", për shkak të shiut të rrëmbyer që ka rënë në Tiranë, përgjatë orarit kur dyqani rri hapur. Megjithatë, Një nga nismëtaret, Iris Luarasi na tregon se edhe dje nuk kanë munguar vizitorët. "Kemi pasur disa shitje edhe sot, jo si ditët e tjera sepse sot ka qenë shumë shi, por vizitorët nuk na kanë munguar", - na tregon ajo. Ata që shkojnë për të blerë në këtë dyqan janë nga të gjitha shtresat dhe nuk e kanë fare problem se të kujt janë rrobat që ata do të marrin. "Madje ka nga ata që duan ta dinë me ngulm se të kujt janë se mund t'iu pëlqejnë si personazhe. Ne kemi një kliente të rregullt, që është e fiksuar pas gjerave që sjell Jonida Maliqi dhe sapo kemi ndonjë gjë të Jonidës ne e njoftojmë. Dhe ajo i blen gjithmonë. Pra nuk përbën fare problem se kush i ka veshur këto rroba", - na shpjegon njëra prej vajzave që shiste dje vullnetarisht në dyqan. Sa i përket rrobave që kanë të varur në dollap, ata në pjesën më të madhe janë firmato, sigurisht të mbajtura mirë dhe me kujdes apo në disa raste edhe të paveshura asnjëherë. Kështu aty mund të gjesh një palë pantallona "Ferre", të cilët çmimi i etiketës tregon se janë blerë rreth 1300 euro, por që shiten vetëm 10 mijë lekë, ashtu siç janë shitur në javën e parë dy fustane "Roberto Cavalli" me nga 5 mijë lekë të reja secili. Një palë këpucë të reja, një shall "Christian Dior" dhe shumë fustane, kostume e pallto të firmave më të njohura në botë.

DHURUESET

Megjithëse vetë Irisi nuk pranon të na tregojë se kush janë gratë e pasura të Shqipërisë që dhurojnë, pasi nuk do t'i japë një ngjyrim politik, kësaj nisme të tyres, ne arrijmë të zbulojmë disa prej tyre. Vjollca Hoxha, bashkëshortja e themeluesit të "Top Channel" Dritan Hoxha, është njëra prej atyre që kanë kontribuuar më shumë për të mbushur dollapët e këtij butiku bamirësi. Deborah Jons, zëvendës ambasadorja amerikane ka dhënë shumë gjëra personale, madje edhe ka ndihmuar duke shitur vullnetarisht, ndërsa shumë donacione kanë ardhur në këtë dyqan nën emrin e bashkëshortes së biznesmenit të njohur në vendin tonë, Zamir Mane. Ndërsa këngëtarja Jonida Maliqi, ka tashmë edhe fansat e saj në këtë dyqan që sapo marrin vesh që ajo ka dhuruar diçka, nxitojnë me vrap ta bëjnë të tyren. Në këtë listë të gjatë ka plot femra të televizionit dhe skenës që dhurojnë

TIRANE

Si iu lindi ideja për të hapur një dyqan të tillë?

Kjo është një ide për herë të parë në Shqipëri, por nuk është një ide për herë të parë në botë. Dyqani të tilla ka kudo. Meqë unë drejtoj një organizatë që ka lidhje me viktimat e dhunës së familjes, në bashkëpunim me miqtë dhe partnerët tanë të huaj po mendonim që si të bëjmë një gjë që qendra të mos varet gjithmonë nga donacionet e huaj.

Të natyrës?

Abazhurë, një set perdesh, një komplet pjatash që janë të mira, por ti i ke në shtëpi prej kohësh... Pjesa tjetër që duhet të targetonim ishin kategoria që do të vinin t'i blinin. Dhe në fakt unë kisha parë që njerëzit ishin të interesuar. Java e parë në të vërtetë ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Nuk ma prisja mendja kurrë që do të kishim kaq shumë njerëz që na vizituan në dyqan, kur ai është i hapur vetëm dy gjysma ditësh: të premten pasdite nga ora 16:00-19:00 dhe të shtunën nga ora 10:00- 13:00.

Kush shet aty?

Aty çdo gjë bëhet vullnetarisht. Unë kam dalë kam shitur vullnetarisht, zëvendës ambasadorja amerikane ka dhënë kontributin e saj duke shitur gjithë ditën e shtunë vullnetarisht.

Besoj se një pjesë e madhe e gjërave që i sjellin në dyqan janë të një cilësie shumë të mirë, firmato?

Po, po. Një pjesë janë të një cilësie shumë të mirë. Janë shitur dy fustane "Roberto Cavalli" që ishin të jashtëzakonshëm, dhe për fatin tonë të keq janë shitur vetëm 5 mijë lekë të reja.

Po pse i shitët kaq lirë?

Në fakt kishim frikë se nuk do të kishim klientë ndaj edhe i vendosëm çmimet kaq të ulëta.

Kush i kishte dhuruar këto fustanet?

Kemi vendosur që të mos i themi emrat e atyre që dhurojnë. Një pjesë e tyre janë figura politike dhe nuk do të donim që të gjithë kësaj nismës sonë t'i jepnin një profil politik. Një pjesë janë figura publike, një pjesë janë gra të pasura që thjesht duan të jenë anonime.

A dhurojnë gratë e politikës?

Një pjesë po.

Cila kategori ka dhuruar më shumë; gra të politikës, të biznesit apo të artit?

Biznesmene. Ne nuk i themi kurrë jo asnjë


Iris Luarasi

lloj gjëje, por bëjmë një lloj seleksionimi të rrobave që shesim në dyqan.

Ata që i blejnë, nuk e kanë problem të veshin rrobën e dikujt tjetër që mund ta takojnë gjatë punëve të tyre?

Unë e kisha këtë frikë, por "boom-i" i madh i njerëzve që na kanë pllakosur në dyqan të premten dhe të shtunën ma rrëzoi çdo lloj dyshimi që kisha.

Po ti vetë, duke e ditur edhe se kush e ka dhuruar, ke pasur tundimin të marrësh ndonjë gjë?

Po, po, kam marrë një çantë për vete. Arsyeja pse e bën këtë gjë është se ti e mendon që edhe duke blerë ke bërë një donacion. E vetmja frikë që kam unë është nëse do të vazhdojë një sjellje e gjërave kaq cilësore, siç na kanë ardhur deri më tani. Sepse shumica e njerëzve kur pastrojnë garderobën, gjërat e mira ua falin njerëzve të tyre. Por ka ardhur koha që njerëzit e pasur, edhe në Shqipëri, të bëjnë një bamirësi edhe nëse nuk merr një falënderim të menjëhershëm.

Po përfaqësitë diplomatike janë të angazhuar?

Një pjesë e tyre janë, me pjesën tjetër po punojmë. Pasi kjo nismë sapo ka nisur. Ambasadori Seqqui na premtoi se do të vijë të sjellë disa gjëra dhe të blejë ca të tjera në dyqan. Gra të tjera të rëndësishme na kanë thënë se do ishin shumë të lumtura të ofronin kontributin e tyre duke shitur vetë një ditë në dyqan.

Ku i merrni këto dhurimet? Keni një ditë të caktuar?

Nuk kemi një orar, por kemi një numër ku ata mund të kontaktojnë dhe në çfarëdo lloj momenti do që ta heqësh pakon, ose lë një orë takimi ose vend takimi dhe ne dërgojmë dikë që ta marri.

Cili ka qenë dhurimi më i shtrenjtë që iu ka ardhur?

Nuk e di, pasi nuk mund ta pyesësh atë që dhuron se sa lekë e ke blerë këtë. Por ka pasur gjëra me shumë vlerë

Po nëse flasim për firma të njohura në mbarë botën, a ka pasur?

Po ka pasur. Aty janë tregtuar kostume "D&Gabbana", çanta "Cartier", "Galiano", nja dy peliçe shumë të shtrenjta, fustane "Roberto Cavalli', pantallona "Barbery", "Hermes", "Versace", "Ferre", etj. Ka pasur edhe disa donacione "Swarovski", të cilat shitur në mënyrë të paparë.

Keni bërë një llogari se sa mund të jenë mbledhur nga shitjet e dy ditëve të para dhe për çfarë do i përdorni të ardhurat?

Në javën e parë të shitjeve janë mbledhur shumë, por nuk do t'i shpenzojmë menjëherë, një pjesë do t'i lëmë për raste emergjente, se ndonjëherë gratë vijnë në strehëz bashkë me fëmijët dhe mund të kenë nevojë që t'u blihen libra, fletore dhe një pjesë e mirë do të shkojë për të mbuluar shërbimet e kështillimit.

Një mesazh për të gjithë ata që ju mund t'i keni bamirës dhe klientë të mundshëm?

Mesazhi i parë është për të gjithë njerëzit e pasur të Shqipërisë, por edhe ata që i përkasin shtresës së mesme dhe që mendojnë se mund të luftojnë dhunën në familje duke kontribuar sado pak, të vijnë ta bëjnë atë donacionin. Mesazhi i dytë është për grupin që kontribuojnë duke blerë do t'u thoja që të rruga "Budi", përballë restorant "Floga", aty ndodhet dyqani jonë "Women we love" dhe mund të kontribuojnë duke blerë diçka.

Gratë e dhunuara

Paratë e mbledhura do të shkojnë për gratë e dhunuara. Iris Luarasi nuk harron të përsërisë disa herë numrin 22 33 408 të qendrës së këshillimit, ku mund të telefonojnë në çdo moment gratë e dhunuara fizikisht dhe emocionalisht. Ndërsa ata që duan të bëjnë një donacion bamirësie për këtë çështje mund të telefonojnë në numrin 066 22 333 13.

Big Brother 5

SURPRIZA *Laura i kishte dërguar Metit një gjysëm zemre, të futur brenda në pishinën e shtëpisë së BB, dhe Meti hyri me gjithë rroba për ta marr*

Meti modeli nga Kosova lë shtëpinë

Konomi doja të dilte Erioni, por edhe Edgari që paragjykon çamët



TIRANE

SUADA DACI



Modeli nga Kosova, Meti lënë shtëpinë e Big Brother Albania. Përreth dy muaj , 23 vjeçari nga Prishtina ishte pjesë e këtij reality shoë, dhe ka qënë shpesh i komentuar edhe në rrjetet sociale sa i takon pamjes së tij. Megjithatë publkiu shqiptar ka vendosur që ai të lë përgjysëm eksperiencën e tij, në këtë reality shoë, duke hequr dorë përfundimisht nga çmimi i madh prej 100 milion lekësh. Ndërkohë 3 banorët e tjerë meshkuj si Arbri, Erioni i cili dilte për herë të parë në nominim dhe Edgari janë ende pjesë e këtij spektakli. Në fillim të spektaklit, opinionisti Arjan Konomi, i cilësoi nominimet e natës së djeshme si shumë të forta. Është një nominim i fortë dhe do të prishë punë kushdo që të dal. Unë do të doja të dilte Erioni, por edhe Edgari që paragjykon çamët", u shpreh Konomi.

Megjithatë "Vëllai i Madh" kishte rezervuar një surprizë të veçantë vëllai i madh kishte rezervuar për Metin. Ai kishte rrëfyer që është i dashuruar me Laurën, me të cilin ishte ndarë, por që ai vazhdon ta dojë shumë. Laura i kishte dërguar Metit një gjysëm zemre, të futur brenda në pishinën e shtëpisë së BB, dhe Meti hyri me gjithë rroba për ta marr. Ajo kërkonte prej tij një premtim që ata të dy të ishin përsëri bashkë, ndaj dhe Meti tha se, " çfarëdo që të ndodh, kur të dal nga BB do të bisedojnë me njëri-tjetrit". " Sinqerisht e dua shumë. Ne do të jemi bashkë dhe më të lumturit në botë! Do të të dua edhe më shumë nëse do të të kem afër", u shpreh Meti. Një tjetër moment që u vu re gjatë spektaklit ishin edhe diskutimet e banorëve gjatë javës. Arbri tha për Ermalin se ai shfaq sjellje patriarkale ndaj Françeskës pasi ai kërkon t'ia mbyllë gojën, sa herë që ajo fillon të flasë e kjo nuk i duket normale në një çift. Françeska thotë se ka qenë një moment i gabuar kur ai ka ndërhyrë mes debatit të Ermalit e Arbrit. Ermali foli edhe për marrëdhënien e Arbrit me Liamin, duke pohuar se ata bëjnë çdo veprim të komanduar e Arbri kundërpërgjigjet duke thënë se ai e Liami kanë mendime të ndryshme e nuk veprojnë në njësoj. Ndërsa Liami u shpreh se tani e tutje do të reagojë me shumë ndaj sulmeve të banorëve për "koalicionin" e tij me Arbrin. Së fundi, opinionisti Arjan Konomi tha se, si në çdo vend, banorët janë munduar ta thyejnë aleancën e dy banorëve të fortë.

Një tjetër surprizë I'u bë edhe Arbrit të shpëtuarit të parë nga publiku. Arbri ka rrëfyer për familjen Prespa, familjen që mikëpriti atë dhe familjen e tij për 3 muaj rresht, në vitin 1999 kur Kosova nuk e kishte ende pavarësinë. Familja Prespa nëpërmjet një videoje rrëfyen se, "Arbri ka qënë një djalë shumë i shkathët dhe i uruan atij suksese në Big Brother.

Françeska-Erionit :

Më vjen mirë që u zgjove nga gjumi dimëror



Erioni u kërkon vajzave që të rrinë dhe ta marrin provën seriozisht, pasi mund të penalizohen edhe të tjerët. Françeska nervozohet nga këshillat e tij dhe i thotë se pavarësisht pakënaqësisë dhe lodhjes, ajo po i reziston provës. Françeska thotë se nëse ai që fiton provën, arrin të marrë vetëm gjashtë muaj vezë falas, atëherë nuk ia vlen qëndrimi zgjuar në pritje të një veze. Erioni i tregon se ai dhe të gjithë të tjerët po mundohen dhe po presin që t'ia dalin deri në fund me provën, por Françeska mendon se ai këtë gjë e bën vetëm për t'u dukur te të tjerët që është i aftë ta përballojë dhe se për këtë është duke e sforcuar veten.

Kështu fillon një debat mes banorëve, të cilët pasojnë batutat e njëri-tjetrit. Françeska i vë në dukje faktin që Erioni është shumë pasiv dhe kërkon shkas që të fillojë debatin me ndonjërin nga banorët. "Më bëhet qejfi që u zgjove nga gjumi dimëror!", i thotë Françeska Erit, ndërsa ai i tregon se ka qenë zgjuar gjata gjithë kohës, por është ajo që nuk e ka vënë re. Ermali u kërkon që të mos vazhdojnë të debatojnë më dhe pas pak minutash të dy banorët e ndërpresin debatin.

Erioni shkon afër pulës së tij dhe i kërkon asaj që ta bëjë vezën, duke i thënë: "Pula ime e dashur, bëjë vezën, bëjë". Ndërsa banorët e tjerë rrinë ulur në tende, ne pritje të vezëve.

Republika e Shqipërisë
"Grumbullim Përpunim Drithi" SH.A

Njoftim

Njoftohen të gjithë aksionerët e "Grumbullim Përpunim Drithi" SH.A Kavajë se më dt 06.05.2012 ditën e djelë, ora 14.00 zhvillohet mbledhja e zakonshme e Asamblesë me këtë rend dite:

1. Miratimi i bilancit për vitin 2011
2. Zgjedhja e organeve drejtuese
3. Të tjera

Mbledhja bëhet në selinë e shoqërisë. Adresa L.nr.2 pranë fushës së vjetër të futbollit

Republika e Shqipërisë
Uzina e Gozhdë- Bullonave Kavajë

Njoftim

Njoftohen të gjithë aksionerët e "Gozhdë-Bullonave" SH.A Kavajë se më dt 04.05.2012 bëhet mbledhja e Asamblesë me këtë rend dite:

1. Miratimi i bilancit për vitin 2011
2. Zgjedhjet e organeve drejtuese
3. Të tjera

Mbledhja zhvillohet ne seline e shoqerisë Adresa L.4 prane stacionit te trenit, Kavajë

Debati

Ermali sqaron zënkën me Françeskën



Gjatë kohës së provës Françes ka debaton me Ermalin, por kjo duket edhe si lojë, pasi ajo qesh. Disa herë Ermali e ofendon duke i thënë me ashpërsi "mbylle gojën". Kjo duket se e ka mërzitur Françeskën dhe për një kohë të gjatë ata kanë ndenjur të distancuar dhe të mërzitur me njëri-tjetrin.

Në një moment Ermali i shkon pranë Françeskës dhe të dy ulen pranë njëri-tjetrit, pak metra larg banorëve të tjerë. Ata fillojnë që të sqarojnë keqkuptimet e mëparshme. Françeska i thotë se ai ka gjithë ditën që e ngacmon dhe i flet me ashpërsi duke e mërzitur. Nga ana tjetër edhe Ermali duket i mërzitur. ai i thotë se edhe Françeska e ka acaruar me shprehjet e saj de i thotë "kur të them hesht, mos vazhdo më" dhe Françeska i përgjigjet "pse të mos e jap mendimin tim në atë moment?". Ermali e sqaron vajzën se ndonjëherë ajo nuk merr parasysh që banorët e tjerë i vëzhgojnë për të marrë sa më shumë informacion dhe më pas të kenë ku të kapen me ta.

Të dy pajtohen dhe rrinë të përqafuar teksa presin që pulat të bëjnë vezë.

[SHQIPTARJA.çuditëse]

Rrëmben fëmijën që të lirojë telefonin

Në një nga rrugët e Richmond-it, qytet në Virginia të SHBA, zonja Lilian Hawkin bashkë me djalin e saj të vogël në karrocë u fut në kabinë dhe filloi të fliste me një shoqe, ndërkohë që karrocën bashkë me djalin e kishte lënë jashtë në trotuar. Papritur, në një moment u kthye për të parë djalin dhe u terrorizua kur pa një goxha burrë që, duke shtyrë karrocën po largohej. E lëhtarisur u lëshua me vrap nga kabina, duke ulëritur me sa kishte në kokë "Ndihmë, më rëmbyen djalin". Mirëpo për habinë e saj burri, pa e prishur fare terezinë, ndaloi, u kthye dhe me një gjest që shprehte qartë se ekishte humbur durimin, i tha: "Më në fund, mbarove! Ka më shumë se pesëmbëdhjetë minuta që pres të për të telefonuar dhe kjo ishte e vetmja mënyrë për të detyruar t'i japësh fund llomotitjeve nga një telefon publik".



Një ofertë për shumë Harry Potter

Pronarët e një stacioni radiofonik në Los Angeles, duke parë suksesin e jashtëzakonshëm të personazhit të Joanne Kathleen Rowling , magjistarit të vogël Harry Potter, vendosën të bënin një ofertë të jashtëzakonshme. Kështu, ata njoftuan përmes radios së tyre se do të jepnin 10 mijë dollarë për këdo që do të quhej, natysrisht duke e provuar me dokumente autentike, Harry Potter. Por nuk kaluan veçse disa ditë, kur pronarët në fjalë e 'drodhën" dhe e tërhoqën ofertën e tyre. Dhe nuk kishin faj, sepse në pak ditë, në redaksinë e tyre u paraqitën plot 560 vetë për të tërhequr çmimin e ofruar. Që të gjithë, mbi bazën e dokumenteve të rregullta rezultonin të quheshin pikërisht Harry Potter.




Një njoftim nga hajdutët

Duke qenë se ishte në pritje të disa miqve të saj, Alma Denny, një zonjë nga Chicago, nga frika se mos vinin e nuk e gjenin, para se të dilte nga shtëpia për të blerë diçka në një supermarket që nuk ishte larg shtëpisë së saj, vendosi t'i njoftonte duke vënë një pusullë në derë, në të cilën ishte shkruar: "Do të kthehem rreth orës 1730 minuta". Dhe e vërteta është se zonja Denny u tregua e përpiktë dhe e mbajti fjalën. Por kur u kthye në shtëpi, jo vetëm që e gjeti derën të shpartalluar, por i mbi derë gjeti edhe një pusullë tjetër në të cilën, hajdutët, që gjatë mungesës së saj kishin pasur kohë për të vjedhur ç'të dëshironin dhe për t'u tallur me të, kishin shkruar: "Do t'ju kishim pritur me shumë kënaqësi, por ja që tani duhet të largohemi..." .



SUPER FJALEKRYQ



■ HORIZONTAL

1. Një provë zjarri.
3. Emri i Delon
7. Kush është… është i zbehtë.
11. Vihet për të mbyllur.
16. Inicialete Seagal aktor.
18. Qyteti me Encierro.
20. U gdhend me Amore-n nga Canova.
21. Është gëzim i madh.
22. Inicialet e Truffaut.
23. Sapo fillojnë.
24. Një hero kombëtar hungarez.
25. Ministria Italiane e Punës.
26. Një liturgji katolike.
29. Janë njerëz pa shtetësi.
31. Tërhiqen me kuaj.
32. Shpiku enët me presion.
35. Mbyllin portat.
37. Emër mbretërish nordikë.
38. Gjysmë rekord.
39. Një lloj ekskavatori.
40. Një organizatë humanitare.
42. Virna aktore.
43. Janë zërat e… ëmbël.
44. Qarkullon në… cilindër.
48. Lumë në Francë.
49. Mbyllin takimin.
50. Është rivali i kampionit në ring.
51. Luajnë në… skenë.
52. Bëjnë arte me re.
53. Inicialet e Kerr aktore.
54. Alain "profesori" i Formula 1.
57. Mund të jenë indianë dhe kinezë.
59. Mihali soprano.
61. Jean i… Leon.
62. Është fjala në.. proverba.
64. Kufizojnë katete.
65. Namatisen nga… fakirët.
66. Janë ëmbëlsira për ditëlënidje.
67. U shkrua nga Torquato Tasso.
69. Hus që u dogj në turrën e druve.
70. Tre të parat në ansambël.
71. Një enë për të larë këmbët.
73. Ngelur pa gur.
75. Pak nostalgjike.
76. Nuk kanë shenjtoré desktop.
79. Kush ka nxiton.
81. Ishte Shqipëria në... Kinostudio.
83. U martua me Inon.
86. Kërcimi në… Tahiti.
87. Simbad i 1001 netëve.
88. Kështu mbaron një kuvend.
89. I famshmi Pacino.
90. Musante aktore.

■ VERTIKAL

1. Është si thes.
2. Një piktor si Monet.
3. Komiku me Giovanni e Giacomo.
4. Fillojnë lojën.
5. Gjysmë ankese.
6. Inicialet Adjani.
7. Është edhe ajo Bayer.
8. Janë ekstreme ndalimii.
9. Fillojnë eksodin.
10. Janë me ngjyra si… alumini.
11. Më i famshëm është ai balash.
12. Është e ftohtë si thika.
13. Kështu fillon periudha.
14. Hajat pa ekstreme.
15. Janë aftësi… prodhuese ose mbajtëse.
16. Janë kolegë të Valentinino-s.
17. Shahu i fundit.
18. Një fjalë e pamjaftueshme.
19. Morbusi i Mohammad Ali.
20. Mariana e… Garcia Lorca-s.
21. Shkroi Shtëpi kukulle.
22. Tosca e Puccini-t.
23. Janë hebrej të Spanjës.
25. Janë mënyra për të mësuar... gjuhë.
27. Ente Prodhuese Lokale.
28. Jep notën La një… i tillë.
30. Një historike përkujtohet.
32. Salvador piktor.
33. Një film… publicitar.
34. Priza po nuk... ra.
36. Shpjegohen me leksione.
39. Ishte babai i Andromedës.
41. Një fetar me adeptë.
43. Kufijtë e matjes.
45. Ylli i Hollywood-it.
46. Është arma… atomike.
47. Këndon Laura non c'é.
54. Një fjalë… e afërt.
55. Girone aktor.
56. Është për të fshehur asin.
57. Qe miku i Eneas.
58. Janë ato që na takojnë.
60. De Vito aktor.
62. Ktheu milingonat në njerëz.
63. Emri i Descartes.
64. Immanuel filozof.
68. Burton regjisor.
72. Një pjesë e galaktikës.
74. Qan te Turandot.
77. I keni në dorë.
78. Inicialet e Dreiser.
80. Mbetur në fund.
82. Inicialet e Duvall.
84. Fillojnë motovin.
85. Janë në qendër.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM



HOROSKOPI

Dashi

Ndonëse qielli juaj duket disi i "turbullt" mes shumë yjeve spikat merkuri, falë të cilit sot mund të arrini të konkludoni një marrëveshje ekonomike me rëndësi. Humori le për të dëshiruar.

Demi

Sot nuk vlen shumë kuraja dhe guximi juaj, pasi me pak dhelpëri mund të arrini objektiva të cilat nuk mund të arrihen kollaj me dy cilësitë e para. Marsi imponon ritme të larta.

Binjakët

Me Merkurin mbi kokë që është edhe ylli juaj i mirë, të nisësh një projekt të ri do të thotë ta fillosh "me këmbë të mbarë". Të shpenzosh për ato që duhen nuk do të thotë të ejsh dorëlëshuar.

Gaforrja

Edhe pse humori juaj duket se dotë jetë i luhatur, në tërësi dita e sotme pritet të jetë e mirë në të gjitha aspektet. Me dialog mun të arrini shumë më tepër nga çmund të bëni nëpërmjet prepotencës.

Luani

Nga njëra anë është Marsi në shenjë ai që sjell një farë frenezie në veprimet tuaja, ndërsa nga ana tjetër, Afërditapremton të rindezë ndjenja të topitura prej shumë kohësh.

Virgjëresha

Në saj të Jupiterit të favorshëm në shenjë sot mund të keni momente kulmore në aspektin ekomik (sidomos për ata që meren me biznes). Një përgjigje që prisnit prej kohe mund t'ju gëzojë.

Peshorja

Me një Merkur super të favorshëm sot do të keni mudësi reale jo vetëm për të fituar më shumë në planin ekonomik, por edhe për të rifituar një miqësi thuajse të humbur.

Akrepi

Ndonëse Merkuri në një pozicion të papërshtatshëm për ju mund të sjellë ndonjë problem të vogël, nuk është mirë që të t'i dranatizoni, siç bëni zakonisht. Erosi duket i ripërtërirë.

Shigjetari

Marsi dhe Merkuri janë në një kontrast të tillë që do të reflektohet edhe te shumë prej të lidurve të kësaj shenje, që për shkak të tij do të jenë nervozë dhe jo shuëm ët shoqëruesëhëm.

Bricjapi

Nëse jeni duke meditur për të marrë një vendim, sot, me hënën e favorshme në shenjë me siguri që do t'i jepni fund hezitimeve dhe do të hidhni hapin e shumëpritur. Mirë shëndeti.

Ujori

Me një kuadër yjor jo edhe aq të kthjellët, është e pritshme një ditë jo shumë pozitive, prandaj edhe humori juaj do të jetë ai që do të jetë. Kujdes në sektorin e financave.

Peshqit

Me Marsin dhe Jupiterin mbi kokë nëaspektin profesional do të ndjeheni "të blinduar", por nuk do të mungojnë edhe sodisfaksionet në fushën financiare. Merruni më shumë me aktivitet fizik.

LAJME NGA BOTA

■ Tërhiqen agjentët e Obamas nga Kolumbia

Agjentë të shumtë të shërbimeve sekrete amerikane, që do të kujdeseshin për sigurinë e presidentit Barack Obama në Kolumbi, janë thirrur në vendin e tyre pas dyshimeve për sjellje negative. Agjencia nuk dha detaje, por raportime të ndryshme sugjeronin për përfshirje të agjentëve me prostitutat në Kartagjenë, ku dhe do të mbahet Samiti i Amerikave. Zëdhënësi i Agjencisë, Edwin Donovan tha për BBC se agjentët ishin zëvendësuar dhe se sigurimi për presidentin Barack Obama nuk do të ketë asnjë mangësi. Në një deklaratë, zoti Donovan tha se Agjencia i ka marrë "shumë seriozisht informacionet për sjellje negative të agjentëve dhe theksoi se një hetim është hapur për këtë çështje. "Ka pasur akuza për sjellje të keqe ndaj personelit të shërbimeve sekrete në Kartagjenë, që është dhe destinacioni prioritar i presidentit Obama", tha zëdhënësi.

■ Koreja e Veriut nuk dorëzohet

Koreja e Veriut nuk është dorëzuar pas dështimit të lëshimit të raketës-satelit. Nga vendi aziatik vijnë lajme të reja për një raketë ndërkontinentale që regjimi komunist po realizon. Lajmin e bën të ditur televizioni koreano-jugor YTN, që citon burime pranë shërbimeve sekrete, që thonë se vektori i ri është testuar 4 herë në 16 javët e fundit. Emri në kod i raketës, që po prodhohet në bregun veri-lindor, është "KN-08". Në fillim të prillit shtypi në Seul kishte zbuluar se Peniani po punonte për një raketë ndërkontinentale, e aftë të arrinte Shtetet e Bashkuara. Në orët e para të ditës së premte, mediat nga e gjithë bota transmetuan lajmin për dështimin e raketës koreano-veriore me rreze të gjatë veprimi, vetëm pak momente nga ngritja në ajër.

■ Për terroristin 12 vjet burgim

Një shtetas pakistanez, që jeton në Shtetet e Bashkuara, është dënuar me 12 vjet burg nga Gjykata në Virgjinia, pasi ka siguruar mbështetje për një grup militant. Xhubair Ahmad, 24 vjeç, është shpallur fajtor në muajin dhjetor. Ai ka pasur lidhje me grupin Lashkar-e-Taiba, i cili nga Shtetet e Bashkuara është shpallur organizatë e huaj terroriste që nga viti 2001. Ky grup është akuzuar për orkestrimin e sulmeve të 2008-ës në Mumbai të Indisë, ku kanë humbur jetën 166 persona. Ahmad ka pranuar se organizata terroriste i ka kërkuar atij të bëjë një video me kreun e grupit, e që do të përfshinte edhe skena të sulmeve në Kashmir.

■ Shpërthim pranë ambasadës amerikane në Kolumbi

Në të njëjtën ditë kur presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama, ka arritur në Kolumbi për të marrë pjesë në Samitin e Amerikës, një shpërthim ka ndodhur pranë ambasadës amerikane në kryeqytetin Bogota, ndërsa dy të tjerë pranë një stacioni autobusësh në Kartagjenë – vendin ku po mbahet samiti.

■ Danimarka akuzon profesorin për spiun të Rusisë

Prokurori danez i shtetit ka ngritur aktakuzë kundër profesorit të Universitetit të Kopenhagës, Tim Kivimaki, për spiunazh në favor të Rusisë, raportojnë mediet në Danimarkë. Kivimaki, me origjinë nga Finlanda, por që jeton në Danimarkë nga viti 1999, akuzohet se ka furnizuar agjentët rusë "me informacione politike dhe të sigurisë, në interes për shërbimin sekret rus". Profesori i ka hedhur poshtë akuzat për spiunazh, por ka pranuar se zyrtarët e Ambasadës së Rusisë i kanë financuar disa analiza në fushën e politikës dhe të sigurisë.

Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:
To Subscribe please contact:

POSTA SHQIPTARE
Tel: +355 4 2375598
e-mail: abonime@postashqiptare.al

Agjensia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)
Tel: +355 682047825
e-mail: arbentrenova@yahoo.com

ADRION Ltd
Tel: +355 4 2240018
e-mail: sales@adrionltd.com

Ja si fillohet dita...



[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...

• Alba Malltezi
Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtore e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Elton Qyno
Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
redaksia@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë